



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË

FACULTY OF LAW

ПРАВЕH ФАКУЛТЕТ

STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**“VEPRAT PENALE SI PASOJË E DHUNËS NË FAMILJE NË
GJYKATËN THEMELORE GOSTIVAR GJATË PERIUDHËS
2014-2019”**

KANDIDATI:

GENTIANA MUSTAFA

MENTOR:

Doc. Dr. VEDIJE RATKOCERI

TETOVË, MARS 2021

DEKLARATË MBI ORIGINALITETIN E PUNIMIT

Vërtetoj se unë Gentiana Mustafa jam autor origjinal i këtij punimi shkencor.

Gentiana Mustafa

“Dhuna ndaj grave është një ndër shkeljet më të turpshme të të drejtave njerëzore” – KOFI ANNAN

FALEMNDERIM

Sa kohë ka kaluar kur e mendoj ditën e parë të studimeve, e tani jam duke i dhënë një përfundim të gjithë atyre 5 viteve duke i përmbyllur me këtë hulumtim timin, njëkohësisht duke e kurorëzuar me një falemenderim.

Pa mbështetje nuk arrihet asgjë, andaj një falenderim i veçantë i shkon familjes time, ajo e cila ka qenë shtytja e parë që nga fillimi, duke më përkrahur financiarisht dhe moralisht. Gjithashtu falenderoj veçanarisht bashkëshortin tim, ai i cili më ka ndihmuar në çdo hap të këtij punimi, si dhe falemnderim për familjen time ligjore.

Një falemnderim i fundit por jo më pak i rëndësishmi i takon mentores-profesoreshës Doc.Dr Vedije Ratkoceri e cila ka treguar një punë të palodhshme duke më përkrahur dhe motivuar të arrij këtë titull.

Ju faleminderit të gjithëve!

PËRMBAJTJA

Deklaratë mbi originalitetin e punimit.....	2
Falenderimi.....	4
Apstrakt.....	7
Абстракт.....	8
Hyrje.....	9
Qëllimi i hulumtimit.....	11
Hipotezat.....	12
Metodologjia e punimit.....	13
Kapitulli I	
1.Të njohim dhunën në familje.....	14
1.1 Nocioni i dhunës në familje.....	15
1.2 Çka është familja.....	17
1.3 Llojet e familjeve.....	18
2. Format e manifestimit të dhunës në familje.....	19
2.1 Dhuna fizike.....	20
2.2 Dhuna psikologjike.....	22
2.3 Dhuna seksuale.....	23
2.4 Dhuna financiare.....	25
Kapitulli i II	
2. Pikëpamje e veçantë mbi gratë dhe fëmijët si viktimat të dhunës në familje.....	26
2.1 Studim i përgjithshëm mbi gratë në rrethinën e qytetit të Gostivarit mbi arsimimin.....	29
2.2 A ndikon dhe si shkalla e arsimimit tek viktimat si pasojë e dhunës në familje.....	31

2.3 Fëmijë të shëndoshë apo me sëmundje të ndryshme si viktimat të dhunës në familje.....	32
2.4 A luan rol mosha e fëmijëve të prekur si viktimat të dhunës në familje dhe në bazë të saj a dallon vepra penale që i prek ato?.....	33

Kapitulli i III

3.Mbrojtja ligjore e viktimave të dhunës në familje në Republikën e

Maqedonisë së Veriut.....	35
3.1 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	37
3.1.1 Strategjia për parandalimin e dhunës në familje.....	39
3.2 Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	41
3.3 Ligji mbi parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje e Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	44

Kapitulli i IV

4. Studimi empirik.....	47
4.1 Veprat penale si pasojë e dhunës në familje në Gjykatën Themelore Gostivar gjatë periudhës 2014-2019.....	47
4.2 Lloji i veprës penale.....	49
4.3 Të dhënat gjinore.....	49
4.3.1 Gjinia dhe mosha e viktimave, raporti familjar me kryerësin.....	50
4.4 Anketë.....	51
Përfundimi.....	54
Literatura e shfrytëzuar.....	55

ABSTRAKT

Çdo herë që më është dhënë mundësia jam munduar të kyçem në katër muret e bisedës rreth dhunës që bëhet në familje. Edhe këtë herë nuk e humba mundësinë të zgjedh rastin dhe të posedoj këtë punim duke hulumtuar, zgjedhur sadopak këtë problem për vendin që më rrethon. Dhuna në familje në çdo kohë ka ekzistuar në forma të ndryshme, çfarëdo qoftë lloji i saj, por gjithnjë e më shumë rastet e dhunës në familje janë në rritje kudo që kthen kokën. Përse ndodh kjo? Kush e shkakton? Çfarë faktorësh duhet të dimë që e ndihmojnë dhunën në familje dhe kush pëson më shumë nga kjo situatë?

Nuk ka formë të lehtë të dhunës në familje duke u nisur nga abuzimi, kërcënimet, fyerjet, lëndimet fizike si dhe forma të tjera, ku të gjithë këto forma duhen studiuar veç e veç dhe të konkludohet se a janë personat kryerës të kësaj vepre penale të njejtë, a vuajnë nga sëmundje të njëjta apo përjetojnë faktorët e njëjta të jashtëm? Kjo ngelet për tu hulumtuar dhe zbuluar gjatë këtij punimi. Është një temë delikate për tu folur në çfarëdo hapësire, pasi që jo çdo person e tregon se ka qenë pre e kësaj vepre penale dhe në momente të caktuara ndjehet 'i etiketuar' si i dobët në shoqëri, kjo të bën edhe më shumë inkurajues të hulumtosh për këto persona dhe qytetin tënd.

Fjalët kyçe: Dhuna në familje, shoqëria, faktorët, vepër penale

АБСТРАКТ

Секојпат кога ќе ми се даде можност, сум се обидувала да се приклучам на четирите сида на разговор за семејното насилство. Дури и овој пат не ја пропуштив можноста да го избирам случајот и да ја поседувам оваа работа за истражување, решавајќи го барем овој проблем за земјата околу мене. Семејното насилство отсекогаш постоело во различни форми, без оглед на неговиот вид, но се повеќе случаи на семејно насилство се зголемуваат каде и да сте. Зошто се случува ова? Кој го предизвикува тоа? Кои фактори треба да ги знаеме кои придонесуваат за семејно насилство и кој страда најмногу од оваа состојба?

Не постои лесна форма на семејно насилство засновано врз злоупотреба, закани, навреди, физички повреди и други форми, каде што сите овие форми треба да се изучуваат одделно и да се заклучи дали сторителите на ова злосторство се исти, дали страдаат од исти болести или ги доживуваат истите надворешни фактори? Ова останува да се истражи и открие во текот на овој труд. Тоа е деликатна тема за разговор на кој било простор, бидејќи не секој човек покажува дека бил жртва на ова злосторство и во одредени моменти се чувствува „етикетиран“ како слаб во општеството, ова ве прави уште похрабрувачки да истражувате за овие луѓе и твојот град.

Клучни зборови: Семејно насилство, општество, фактори, кривично дело

HYRJJE

Dhuna në familje paraqet shkeljen më brutale të të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike dhe si e tillë ajo duhet të ketë një trajtim të veçantë nga institucionet shtetërore. Nëse këto institucione funksionojnë ashtu siç duhet, trajtojnë çështjen e dhunës në familje dhe ndikimin e saj në përmirësimin e kualitetit të mbrojtjes me masa sistematike në fushat e preventivës, intervenimet, aq më rrallë do të paraqitet dhuna në familje.

Shumë studime nëpër botë raportojnë se çdo vit figuron një numër i madh i rasteve të shumë grave dhe burrave si viktime të dhunës në familje, si: Studimi kombëtar i abuzimit në familje për vitin 2005 raportoi se 213.000 gra dhe 88.000 burra ishin viktime të dhunës në familje, si viktime të abuzimit të rëndë fizik, abuzimit emocional ose abuzimit seksual.

Do ishte me rëndësi të cekim se vetëdijesimi për paraqitjen e rasteve apo rreth mendimit që të dënohet dhunuesi, është shumë i rëndësishëm. Me ndihmën e kësaj krijohet një kujdes adekuat ndaj viktimave, ndihma nga ana institucionale, pa marrë parasysh llojin e ndihmës qoftë ajo psikologjike apo financiare. Në këtë mënyrë ne si shoqëri, viktimave të dhunës në familje u tregojmë interesin tonë ndaj tyre që ata të mos ndjehen të anashkaluar apo të etiketuar në shoqëri.

Për dhunën në familje si fenomen dhe si formë e kriminalitetit është shkruar shumë, si në aspektin ndërkombëtar ashtu edhe në atë nacional. Shumë hulumtues kanë shkruar për shkaqet e paraqitjes, format e paraqitjes, për politikën preventive të shtetit, për inkriminimin penal të dhunës në familje e kështu me radhë. Ndryshe nga kjo, ajo çfarë ne duam të hulumtojmë është aspekti viktimologjik i dhunës në familje. Nuk themi se edhe në këtë aspekt nuk ka hulumtime të deritanishme, mirëpo në krahasim me hulumtimet e lartpërmendura, ky aspekt prapë se prapë është më pak i pranishëm në hulumtimet shkencore.

Ne si shoqëri, si shtet, mendoj se duhet të përqendrohemi më shumë te mbrojtja e viktimave, te trajtimi i tyre adekuat institucional, ligjor, krejt kjo me qëllim që sado pak të zbusim dhimbjen e tyre, të ju ndihmojmë në rehabilitim, risocializim dhe të ju ofrojmë kushte për një jetë më cilësore dhe të ndryshme nga ajo që kanë pasur deri më tani (sa kanë qenë viktime të dhunës në familje).¹

¹ Ratkoceri, Vedije - Mbrojtja institucionale dhe ligjore e viktimave të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë, temë masteri, Universiteti i Tetovës, Tetovë 2012 fq.5

Nëse shteti u ofron mbrojtje dhe ndihmë adekuate viktimave të dhunës në familje, nuk ka dyshim se kjo do të ndikojë që kjo dhunë të denoncohet në organet kompetente dhe në këtë mënyrë të ndikohet në zvogëlimin e numrit të errët të kësaj veprë penale, që pa dyshim është shumë i madh.

Në rastet e dhunës në familje, ku viktimat kryesisht janë personat më të dobët, femrat, fëmijët, prindërit e paaftë, nuk mjafton vetëm vetëdijesimi për paraqitjen e rastit apo dënimi i dhunuesit, është më se e nevojshme kujdesi adekuat ndaj viktimave, trajtimi i tyre institucional, ndihma (psikologjike, financiare), mbrojtja nga dhunuesi e kështu me radhë, sepse viktimat në numrin më të madh të rasteve nuk paraqesin dhunën në familje apo e tolerojnë atë për shkak të varshmërisë që kanë nga dhunuesi dhe nga frika se nëse paraqesin dhunën do të hasin në vështirësi qenësore për të vazhduar jetën. Andaj, duhet të ju dëshmojmë atyre (viktimave) se ne si shtet, si shoqëri, përkujdesemi për ta dhe ju ofrojmë mbrojtje e kushte adekuate për vazhdimin e jetës më të mirë, pa dhunë, pa frikë, në një harmoni dhe mirëqenie familjare, pikërisht ashtu siç funksionon një familje e shëndoshë.²

Në qytetin e Gostivarit çdoherë kanë qenë mangët publikimi apo ndihma nga institucione ku mund të marrësh burime sa i përket kësaj fushe, apo të themi më drejtë mungesa e informacioneve statistikore ka mbizotëruar. Kjo nuk e anashkalon faktin që edhe qyteti jonë në të shumtën e kohës zbulon problematikat që kanë familje të ndryshme duke pësuar dhunën që aplikohet në familjet e tyre. Gjatë këtij punimi duke cekur vitet hulumtuese 2014-2019, do të hasim numër të rasteve që varion nga viti në vit, do të shohim llojet e veprave penale dhe se si janë aplikuar ato tek viktimat nga ana e dhunuesit.

Vet termi “dhuna në familje” në shoqërinë tonë filloi turpshëm të deportojë në vitet e fundit të shekullit njëzet. Promovimi i dukurisë së dhunës në familje filloi në vitin 1994, ndërsa aktivitetet e para të sektorit joqeveritar në lidhje me këtë dukuri u orientuan drejt njohjes së këtij fenomeni në shoqëri dhe drejt sigurimit të ndihmës dhe përkrahjes së grave viktimat dhe fëmijëve të tyre. Me ndryshimin e legjislacionit nacional, Ligjit për familje dhe Kodit Penal në vitin 2004, ku për herë të parë dhuna në familje kategorizohet si krim, problemi i dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut humb karakterin e tij si çështje private e familjes dhe si temë tabu. Ndryshimi i botëkuptimit që dhuna në familje është kryesisht një çështje private, përforcon qëndrimin që dhuna në familje duhet të definohet dhe të shihet jo vetëm si kërcënim për viktimat individuale, por edhe si kërcënim për tërë shoqërinë.

² Ratkoceri, Vedije - Mbrojtja institucionale dhe ligjore e viktimave të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë, temë masteri, Universiteti i Tetovës, Tetovë 2012 fq. 6

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Familja është e para nga grupet më kryesore të shoqërisë, pasi aty fillon vetëdija për një jetë të shëndoshë. Ka shumë përkufizime të ndryshme rreth termit ‘familje’ por të gjitha vin në konkluzion që familje është ajo që bashkëjetesa, mirëkuptimi dhe respektimi i njëri tjetrit janë bazë që ajo të rri në këmbë.

Dhuna në familje mund të ekzistoj në çdo cep, andaj rëndësia e këtij punimi është të marrim parasysh dhe mbi ndërgjegjen tonë personat që vuajnë nga ky fenomen, të zbulojmë se kush janë kryerësit, të ndihmojmë ata edhe në raste pas traumave, të ngrejmë vetëdijësimin e njerëzimit se kjo nuk është një mënyrë e të jetuarit.

Vlerësohet se nga 87,000 gra që u vranë qëllimisht në vitin 2017 globalisht, më shumë se gjysma (50,000- 58 përqind) u vranë nga partnerë intimë ose anëtarë të familjes, që do të thotë se 137 gra në të gjithë botën u vranë nga një anëtar i tyre familja çdo ditë. Më shumë se një e treta (30,000) e grave të vranë me dashje në 2017 u vranë nga partneri i tyre i tanishëm ose ish-intim.

Gjithashtu, vlerësohet se 35 përqind e grave në të gjithë botën kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga partneri në një pikë të jetës së tyre. Sidoqoftë, disa studime nacionale tregojnë se deri në 70 përqind të grave kanë përjetuar dhunë fizike / ose seksuale nga një partner intim në jetën e tyre.

Me këtë nënkuptojmë se në çdo vënd të botës kemi shifra shumë të larta nga ajo që ne mund ta imagjinojmë se mund të ndodhin raste të çdo lloj dhune në familje. Kjo është mungesë e paraqitjes së rasteve, studimeve, hulumtimeve të këtyre fenomeneve, mbrojtjes së tyre, mungesë e mediave vendase apo çdo lloj komunikimi me qytetarët për të bërë të ditur se a janë të prekur njerëzit nga dhuna në familje, të ngrenë vetëdijësimin se ky veprim është i dënueshëm dhe njëkohësisht bëhet shkelja e ligjit.

Andaj, qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është mungesa e këtyre informacioneve. Gjithashtu, në qytetin tim gjithmonë kanë munguar të dhëna se sa është numri i viktimave të dhunës në familje, gjinia e tyre dhe mbi të gjitha të dimë sa kryerës na rrethojnë si dhe të informojmë popullin çfarë masash duhet të merren në raste të këtilla.

HIPOTEZAT

Dhuna në familje paraqet shkeljen më brutale të të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike dhe si e tillë ajo duhet të ketë një trajtim të veçantë nga institucionet shtetërore. Nëse këto institucione funksionojnë ashtu siç duhet, trajtojnë çështjen e dhunës në familje dhe ndikimin e saj në përmirësimin e kualitetit të mbrojtjes me masa sistematike në fushat e preventivës, intervenimit, aq më rrallë do të paraqitet dhuna në familje.

Andaj si hipotezë kryesore do të figuroj:

- Veprat penale të kryera në kuadër të dhunës në familje në territorin e Gjykatës Themelore Gostivar nga viti 2014-2019 shënojnë rritje;

Për ta mbështetur hipotezën që përmendet më lartë do të vijojnë dy hipoteza ndihmëse:

- Gjinia e viktimave të veprave penale si pasojë e dhunës në familje në territorin e Gjykatës Themelore Gostivar në të shumtën e rasteve janë gjinia fëmërore;
- Dhuna në familje në territorin e Gjykatës Themelore Gostivar vijon të mos raportohet aq sa duhet;

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për hulumtim, kërkim, studim të rasteve lidhur me këtë punim do të shfrytëzohen këto metoda:

- Metoda normative; do të analizojmë dispozitat ligjore të legjislacionit të RMV për veprat penale lidhur me dhunën në familje;
- Metoda statistikore; do të përdoret për të paraqitur të dhënat rreth numrit të veprave penale si pasojë e dhunës në familje në Gjykatën Themelore Gostivar gjatë periudhës 2014-2019;
- Metoda historike; do të na ndihmoj të marrim informacione dhe të studiojmë a ka pasur në çdo kohë dhunë në familje dhe si janë luftuar/përballur ato;
- Metoda e anketës dhe intervistës;

KAPITULLI I

1. Të njohim dhunën në familje

Gratë e dhunuara për shumë vite gjatë martesës dhe intensiteti i dhunimit të tyre, u ka bërë jetesën tepër të vështirë dhe shpeshherë rrethi i të dhunuarve në familje është rritur duke u shtrirë nga gruaja te fëmijët që kanë përjetuar ngjarje të rënda të dhunës në ambientin familjar. Në një intervistim të kryer me një kampion prej 15 grash të cilat kanë pranuar se janë dhunuar në familje, kanë treguar se bashkëshortët e tyre i kanë izoluar brenda familjeve duke mos i lejuar ato të punësohen, të dalin lirisht në komunitet apo të kenë marrëdhëniet e tyre të lira me miq. Pyetjes, se si kanë mundur ta duronin këtë situatë dhune, ato i janë përgjigjur duke evidentuar faktorë të ndryshëm, si: përgjegjësitë e tyre ndaj fëmijëve; pafuqinë e tyre për të ndryshuar situatën ku gjendeshin; faktin që nuk kishin ku të shkonin, familjet e tyre i kishin mësuar të qëndronin pranë burrave të tyre, në të mirë e në të keq; pamundësinë për të gjetur punë të paguar mirë për të mbajtur fëmijët nëse do të përpiqeshin të iknin bashkë me ta, kështu që e shihnin të ardhmen e tyre të errët e pa rrugëdalje; frika se edhe sikur të iknin nga bashkëshortët e tyre dhunues, ata do t'i gjenin kudo ku ato të shkonin dhe kështu do të vinin në vështirësi edhe familjarët apo të njohurit e tyre etj. Nga ana tjetër, në rastet kur viktimat e kanë raportuar dhunën te organet e policisë në komunitetin ku kanë jetuar, janë përballur me pandjeshmërinë e forcave të policisë ndaj këtyre rasteve të dhunës. Madje ka pasur raste kur i kanë “këshilluar” të kthehen në familjen e tyre, pasi punonjësi i policisë ose ka pasur njohje me dhunuesin, ose e ka paragjykuar gruan që ka raportuar dhunën. Shumë nga gratë që janë dhunuar, vijnë nga rrethina e komunitete të thella të vendit ose nga qytete të vogla dhe, për rrjedhojë, qytetarët njihen me njëri-tjetrin, ose vijnë nga subkultura ku raportimi i dhunës mbetet ende çështje tabu dhe për rrjedhojë, rastet e dhunës në familje nuk janë vlerësuar me seriozitetin e duhur, për pasojat e humbjes së jetës së dhunuesve që këto raste kanë sjellë. Duke pasur parasysh karakteristikat e lartpërmendura, për profilin e grave të këtij grupi, mund të thuhet se ai përbën një grup të qartë të grave që i janë drejtuar krimit të ndikuara nga dhuna në familje. Vlen të evidentohet fakti se edhe gjatë procesit gjyqësor penal, dhuna në familje nuk është konsideruar si faktori vendimtar, që e ka çuar një grua drejt kryerjes së veprës penale të vrasjes dhe, për rrjedhojë, të përdroreshin hapësirat ligjore të rrethanave lehtësuese në dhënien e vendimit të formës së prerë të burgimit. Kthimi në familje pas lirimit nga burgu për gratë-viktima të dhunës në familje

duket se është një problem më vete. Me të drejtë, rrit frikën që i karakterizon ato për rifillimin e jetës, sidomos për rivendosjen e plotë të marrëdhënieve me fëmijët, anëtarët e familjes apo komunitetin. Disa prej tyre kanë humbur lidhjet dhe marrëdhëniet e ngushta me fëmijët, pasi familjarët e ish-bashkëshortëve të tyre kanë kontribuar në humbjen e këtyre marrëdhënieve, pasi nëna e tyre ka filluar jetën në një institucion të vuajtjes së dënimit. Sakaq, arrihet në përfundim se dhuna në familje ka prodhuar izolimin e grave që kur ato ishin në komunitet në gjendje të lirë, mjedis në të cilin kanë përjetuar forma të ndryshme të përjashtimit dhe që më pas i ka shtyrë drejt konsumimit të veprave penale.³

1.1 Nocioni i dhunës në familje

Ekzistojnë shumë nocione apo definicione rreth dhunës në familje, por nuk ekziston ndonjë përkufizim universal rreth asaj, por megjithatë dhuna si fjalë nga Organizata Botërore e Shëndetit përkufizohet si: “Përdorimi i vullnetshëm i forcës apo fuqisë fizike, si kërcënim ose e aplikuar kundrejt një personi tjetër apo komunitet duke pasur me gjasë rezultate ose mundësi në dëmtime, vdekje, pasoja psikologjike, keq zhvillim ose pamundësi megjithëse grupi është i vetëdijshëm që përfshirja e përdorimit të forcës në përkufizimin e vet shtrihet përmbi kuptimin konvencional të fjalës”.⁴

Rreth dhunës në familje ekzistojnë disa mendime se “dhuna prek vetëm një shtresë apo grupe të caktuara”, “dhuna është problem i të varfërve”, “gratë e dhunuara qëndrojnë në marrëdhënie të dhunshme sepse ato e pranojnë dhunën”, etj. Dhuna në familje është një problem që prek të gjitha shtresat dhe grupet e shoqërisë, pa dallim race, niveli ekonomik, etnie, besimi fetar, moshe etj. Besoj se në çdo vend ku dallohet se ka dhunë në familje, është përgjegjësia e shtetit apo komunitetit të ndërmarrin veprimet e duhura për ta ndaluar atë.

Çështja e dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e rregulluar me ligj të veçantë siç është Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje. Definicione për dhunën në familje hasim edhe në Konventat dhe Rezolutat e ndryshme ndërkombëtare që janë miratuar nga kjo sferë e që kanë për qëllim parandalimin e dhunës dhe ofrimin e mbrojtjes adekuate për viktimat. Gjithashtu të shumta janë edhe definicionet që hasen në literaturën e shumtë që trajton këtë tematikë.

³ <https://www.amnesty.org/download/Documents/76000/eur110022006sq.pdf>

⁴ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Dhuna> Krug et al., "World report on violence and health", World Health Organization, 2002.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhunën në familje e definojnë kështu: “Me dhunë familjare nënkuptohet malltretimi, fyerja e vrazhdë, kërcënimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore apo dhunë tjetër psikike apo fizike me të cilën shkaktohet ndjenjë e pasigurisë, kërcënim apo frikë, ndaj bashkëshortit/bashkëshortes, prindërve apo fëmijëve si dhe personave të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore apo jashtëmartesore apo në bashkësi të përbashkët, si dhe ndaj bashkëshortit/bashkëshortes së mëparshëm-me apo personave tjerë që kanë fëmijë të përbashkët apo gjenden në raporte të afërta personale.”⁵

Me nocionin dhunë në familje nënkuptohet keqtrajtimi, ofendimi, rrezikimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore apo dhuna tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, rrezikimit ose frikës, duke përfshirë edhe kërcënime për veprime të tilla, ndaj bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve ose personave tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose ekonomi të përbashkët familjare, si dhe ndaj bashkëshortit të tanishëm apo të mëparshëm, partnerit jashtëmartesor ose personave që kanë fëmijë të përbashkët ose janë në marrëdhënie të afërta personale, pa marrë parasysh nëse kryerësi e ndan ose e ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën ose jo.⁶ Dhuna në familje përfshin kombinim të pushtetit dhe të kontrollit që shfrytëzohen për të shkakuar dhimbje dhe frikë tek viktimja, me qëllim që të ketë kontroll mbi të, të poshtërohet dhe të dobësohet. Dhuna në familje është mënyrë e sjelljes sipas së cilës një partner intim, ose anëtar i familjes më të gjerë përdor dhunë fizike, detyrim, frikësim, izolim ose keqpërdorim emocional, seksual ose ekonomik për të kontrolluar partnerin/anëtarin tjetër të familjes në lidhjen/amvisërinë.⁷

Dokumenti i parë ndërkombëtar më i rëndësishëm i cili veçanërisht merret me dhunën kundër grave si shkelje e të drejtave fundamentale të njeriut dhe i cili e definojnë të njëjtën duket se është Deklarata e OKB-së për eliminimin e dhunës kundër grave. Neni 1 i kësaj Deklarate thotë: “Nocioni dhunë kundër grave nënkupton çdo akt të dhunës në bazë gjinore i cili rezulton ose ekziston besueshmëri se do të rezultojë në lëndim fizik, seksual apo psikologjik si dhe shkakton pësim të grave, duke përfshirë këtu edhe kërcënimet për akte të

⁵ Doc. Dr. Afrim Osmani, Furkan Kodi penal Shkup, 210, fq

⁶ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, neni 3

⁷ Bistra Netkova, Ciceron për anëtarët e odës së avokatëve e cila u siguron ndihmë juridike viktimave të dhunës në familje, Shkup, 2010, f.10.

tilla, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse këto ndodhin në publik apo në jetën private.⁸

Sipas Konventës së Stambollit qëllimi i saj është mbrojtja e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve janë gurët e themeleve të kësaj konvente. Ajo synon gjithashtu të ndryshojë mendësitë e individëve duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje. Në thelb, konventa është një thirrje e re për barazi ndërmjet burrave dhe grave, pasi dhuna ndaj grave i ka rrënjët thellë në pabarazinë shoqërore dhe ka vijuar për shkak të kulturës të mostolerancës dhe mohimit, si dhe synon të sigurojë tolerancë zero për këtë lloj dhune dhe është një hap i madh përpara për ta bërë Evropën më të sigurt.⁹

Dhuna në familje është një fenomen që lëkund vlerat e shoqërisë demokratike. Të dhënat krahasuese dhe empirike për dhunën në familje shkojnë në favor të pikëpamjes që familja, si bashkësi themelore shoqërore dhe si burim i mbështetjes emocionale, sociale e materiale për anëtarët e saj, shpesh herë mund të shëndrrohet në një ambient të dhunshëm ku lëndohen anëtarët e saj dhe shkelen rëndë të drejtat e tyre të njeriut. Stereotipi që dhuna në familje është vepër e vogël triviale, inherente për çdo familje, është në mënyrë të drejtpërdrejtë në kundërshtim me të gjitha rezultatet që janë grumbulluar nga hulumtimet mbi viktimat në vend dhe jashtë tij që viktimat e dhunës në familje i nënshtrohen një dhune më të madhe për dallim nga viktimat e ndonjë krimi tjetër të dhunshëm¹⁰

1.2 Çka është familja?

Familja si fjalë rrjedh nga gjuha latine: *familia*, nga *famulus* që do të thotë rob shtëpie, shërbëtor. Familja është mjedisi i parë shoqëror i fëmijës dhe nga kjo rrjedh se gjërat primare nga ana e edukimit fëmija i mëson nga prindërit pavarësisht se në vitet e mëvonshme që mund ti përsëriten nëpër institucione. Është njësia shoqërore më e vogël e përbërë nga dy ose

⁸ Deklarata e OKB-së për eliminimin e dhunës kundër grave, miratuar me Rezolutën e Asamblesë së përgjithshme A/RES/48/104, 20.12.1993

⁹ Konventa e këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

¹⁰ Davis, R. (1998) , *Domestic Violence: Facts and Fallacies*, Ëestport: Praeger Publishers, ST.Çaçeva, V., Frishçiq, J., Mishev, C., (2007), *Jetë në hije*, ESE.Shkup

më shumë persona të cilët kanë midis tyre lidhje martesore, gjaku ose birësimi që jetojnë në të njëjtin mjedis për një kohë relativisht të gjatë ku gjithashtu përkujdesen për njëri-tjetrin.¹¹

Sipas Deklaratës së Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut “familja është njësi bazë grupore e shoqërisë dhe i jepet mbrojtje nga shoqëria dhe shteti”. Sociologjia dhe antropologjia, familjen e konsiderojnë si funksion thelbësor të reproduktimit biologjik, shoqëror ose të dyja bashkë – shoqëria. Antropologët përmendin tre lloje të familjes matrifokale (amësore) konsanguinile (gjaklidhëse) konjugale (bashkëshortore), mirëpo kjo ndarje ka të bëjë me familjet “ideale”.¹²

Në legjislacionin nacional, familja përkufizohet edhe në Ligjin mbi familjen, ku në nenin e dytë thuhet se: Familja është bashkësi jetësore e prindërve, fëmijëve dhe të afërmeve të tjerë në qoftëse jetojnë në një amvisëri të përbashkët.¹³

Me këtë ligj rregullohen: martesat, dhe familja, marrëdhëniet në martesë dhe familje, disa forma të mbrojtjes së veçantë të familjes, dhuna familjare, adoptimi, kujdestaria, mbajtja si dhe procedura për përcaktimin e masës së përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje.¹⁴

1.3 Llojet e familjeve

Ashtu siç ekzistojnë shumë nocione për termin se çfarë është familja, ashtu kemi të bëjmë edhe me ndarjen e saj nëpër grupe dhe karakteristika të ndryshme.

Varësisht nga kriteret dhe elementet, familja mund të klasifikohet në lloje të ndryshme. Në literaturën juridike hasen këto klasifikime më të rëndësishme të familjes: klasifikimi historik, sociologjik dhe juridik.¹⁵

Sipas kriterit historik, familja mund të klasifikohet në tri lloje të rëndësishme:

- 1.) Familja matriarkale
- 2.) Familja patriarkale dhe
- 3.) Familja egalitare bashkëkohore.¹⁶

¹¹ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Familja>

¹² https://sq.wikipedia.org/wiki/Deklarata_Universale_p%C3%ABr_t%C3%AB_Drejtat_e_Njeriut

¹³ Legjislacionin nacional- Ligjin mbi familjen, neni 2

¹⁴ Po aty Neni 1

¹⁵ Hamdi Podvorica, E drejta familjare, Prishtinë 2005, fq.33

Familja sipas kriterit sociologjik, më së shpeshti bëhet sipas natyrës së marrëdhënieve familjare, stabilitetit të lidhjeve familjare, marrëdhënieve pasurore, përkatësisë së klasave apo të shtresave. Kështu, familja klasifikohet në dy lloje:

- 1.) patriarkale (autoritative)
- 2.) demokratike (egalitare)¹⁷.

Sipas kriterit juridik, hasen po ashtu dy lloje të familjes sipas tipologjisë juridike:

- 1.) familje sipas përbërjes numerike të anëtarëve të gjinisë; familje e vogël, familje e gjerë dhe familje e madhe.
- 2.) familje sipas mënyrës së themelimit; familje martesore, familje jashtëmartesore dhe familje e birësimit.¹⁸

2. FORMAT E MANIFESTIMT TË DHUNËS NË FAMILJE

Duke pranuar natyrën strukturore të dhunës kundër grave si dhunë gjinore dhe se dhuna kundër grave është një prej mekanizmave thelbësore sociale me të cilin gratë janë të detyruara të vendosen në një pozicion varësie në krahasim me burrat.

Sipas statistikave në Republikën e Maqedonisë së Veriut si forma më të përhapura të dhunës në familje janë:

- Dhuna fizike;
- Dhuna psikike;
- Dhuna seksuale;
- Dhuna ekonomike;

¹⁶ Hamdi Podvorica, E drejta familjare, Prishtinë 2005, 34

¹⁷ Po aty, faqe 35

¹⁸ Po aty, faqe 35,38

2.1 Dhuna fizike

Një ndër format më të shpeshta të manifestimit të dhunës në familje është dhuna fizike sipas Organizatës Botërore të Shëndetit përkufizohet si: përdorim i vullnetshëm i forcës apo fuqisë fizike, si kërcënim ose e aplikuar kundrejt një tjetri person ose komunitet duke pasur me gjasë rezultate ose mundësi në dëmtime, vdekje, pasoja psikologjike, keqzhvillim fizik. Kryesisht kjo formë e manifestimit të dhunës ka ekzistuar ekziston dhe do të ekzistojë. Me fjalë të tjera dhuna fizike nënkupton përdorimin e dhunës fizike nga një person apo anëtar i familjes i cili në këtë rast paraqitet si dhunues, drejtuar një antari të afërt të familjes duke e llogaritur këtë të fundit si viktimë të dhunës.

Kjo formë e dhunës mund të shprehet në shumë forma si: shuplaka, shtyerje, tërheqje, kafshim, përvëlim, shkelmim etj. Mund të lind pyetja se si mund të rezultojë dhuna dhe në çfarë formash mund të jetë e dukshme, gjithashtu mund të manifestohet si: mavijosje, prerje, lëndime me thikë, rrënje të fikët, thyerje dhëmbësh, lëndim i syrit etj. Kryesisht të flasim pak për viktimat dhe se si ndikon dhuna në familje tek ata. Ata të cilët preken më shumë gjatë kësaj situate janë persona të cilët e vuajnë këtë dhunë, që janë viktimat e dhunës në familje në këto raste ku ato me shumë vështirësi e pranojnë këtë për shkak se frika, humbja e vetëbesimit, depresioni dhe pagjumësia janë pasojat më të shpeshta që ndikojnë direkt tek ata. Në disa raste dhuna ka shkaktuar edhe sëmundje të caktuara psikike. Kryesisht ky lloj i dhunës perceptohet më lehtë nga rrethi për shkak të natyrës që ka dhe për shkak të gjurmëve të dukshme që i len te viktima. Gjithashtu, sipas të gjitha statistikave, kjo formë është forma që më së shumti denoncohet në organet kompetente, qoftë nga vet viktimat apo nga personat e tjerë. Dhuna fizike manifestohet në kombinim me format e tjera të dhunës. Zakonisht ku ka dhunë fizike ka edhe dhunë psikike, madje edhe seksuale.¹⁹

Gratë që dyshohet se nuk janë “të rregullta” dhe “korrekte” në marrëdhëniet bashkëshortore shpesh bëhen viktima të formave ekstreme të dhunës fizike. Ato jo vetëm janë rrahur, lidhur me litar, por ju janë shuar cigare në trup, janë tërhequr zvarrë, ju janë thyer eshtrat ose janë lënë natën jashtë derës së shtëpisë të vetme dhe të dhunuara.²⁰

¹⁹ Vedije Ratkoceri, Mbrojtja institucionale dhe ligjore e viktimave të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë, Tetovë 2012

²⁰ Qendra e Aleancës gjinore për zhvillim, Raporti: Dhuna në familje: paraqitje e situatës aktuale, Tiranë, 2006

Dhuna fizike në përgjithësi ushtrohet duke filluar nga format më të lehta për të arritur deri tek ato më ekstremet. Dhunuesit janë tepër testues dhe të kujdesshëm me rritjen e nivelit të dhunës. Përgjithësisht kjo formë e dhunës takohet pas vitit të parë të martesës, gjatë shtatzënisë, për t'u përshkallëzuar pas lindjes së fëmijës së parë e për të vazhduar gjatë gjithë jetës bashkëshortore nëse gruaja nuk e kundërshton atë ose nuk gjen një mënyrë për të shpëtuar prej saj. Të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm grash, viktimat të dhunës në familje, e kanë përjetuar atë që në familjen e origjinës. Viktimat tregojnë se edhe nënat e tyre janë abuzuar njësoj nga bashkëshortët dhe kurrë nuk e kanë kundërshtuar atë. Çfarë është edhe më e dhimbshme, ndonëse këto nëna janë lutur për një jetë më të mirë të vajzave të tyre, prapëseprapë ju kanë dhënë atyre mesazhin se “burrat duhen duruar.”²¹ Kjo formë e dhunës në shtetin tonë më shpesh shprehet nëpërmjet shuplakave (87,5%), kërcënimeve për përdorim të dhunës fizike, tërheqje dhe shtyrje (63,9%).²²

Por, dhuna fizike është e shprehur edhe nëpërmjet shumë formave të rënda si shkelmim, kafshim, përvëlim etj. Shpeshësia e manifestimit të mëvetësishëm të dhunës fizike, e bën këtë dukuri më të vështirë dhe më të rrezikshme. Gratë viktimat në vendin tonë kanë qenë viktimat të dhunës fizike të shumfishtë. Më shpesh, çdo e katërta grua, ka thënë se një deri në dy herë ka qenë e sulmuar fizikisht në suazat e familjes së saj. Pothuajse, çdo e pesta grua (18,9%) ka paraqitur dhunë fizikë mbi 20 herë.²³

Fëmijët në të shumtën e rasteve janë viktimat direkte apo indirekte të dhunës në familje sepse ata janë lidhur ngushtë në familje duke i llogaritur si mbështetje të tyre.

Kjo formë e dhunës mund të ndikoj keq në aspektin e tyre zhvillimor, fizik, emocional, social pasi nuk mund të kërkojnë ndihmë edhe nëse këtë mund ta bëjnë i ndalon frika apo kërcënimet që kanë nga anëtarët e tyre të familjes i cili paraqitet si dhunues.

Fëmijëria nga disiplinat mjekësore, psikologjike e pedagogjike konsiderohet si një periudhë vendimtare për të ardhmen e zhvillimit të fëmijëve si individë dhe si qytetarë. Rëndësia e kësaj periudhe për gjithë zhvillimin e mëtejshëm e bën të domosdoshme që për fëmijët të tregohet kujdes i posaçëm për t'ua plotësuar atyre nevojat zhvillimore. Njëra prej tyre është nevoja për siguri dhe pa plotësimin e kësaj nevoje është e pamundur të kemi individë të

²¹ Qendra e Aleancës gjinore për zhvillim, Raporti: Dhuna në familje: paraqitje e situatës aktuale, Tiranë, 2006

²² Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, Hulumtimi: Jeta në hije, Shkup, 2007

²³ Po aty.

shëndetshëm dhe qytetarë të përgjegjshëm.²⁴ Dhuna ndaj fëmijëve në shoqërinë tonë në të shumtën e rasteve aplikohet si masë edukuese dhe si qortim për veprimin e bërë. Me rrahjen e fëmijës, si metodë e disiplinës, arrihen shumë më shumë efekte negative sesa pozitive, sepse fëmijët mund të marrin agresionin si model të sjelljes.

Shumë fëmijë u nënshtrohen formave të ashpra dhe degraduese të dhunës dhe të poshtërimit si: rrahja, incesti, abuzimi seksual, braktisja, shitja e fëmijëve për shfrytëzim dhe prostitucion, krime nderi, e deri tek abortet selektive. Vitet e fundit janë raportuar gjithnjë e më shumë raste të abuzimeve seksuale nga prindër, mësues e persona të tjerë mbi fëmijët si edhe raste të vdekjes për shkak të dhunës.²⁵

2.2 Dhuna psikologjike

Dhuna psikologjike paraqet formë të frikësimit sistematik, maltretimit apo të sjelljes tjetër e cila e kufizon lirinë në sjelljen e viktimës kundër vullnetit të tij/saj. Kjo kyç detyrim të viktimës që të pësojë depërtime në lirinë dhe sigurinë e saj.²⁶

Dhuna psikologjike mbi gruan përfshin kontrollin e lëvizjes dhe kontaktet e gruas, xhelozinë, pronësinë si dhe çdo sjellje që mund të shkaktojë brenga emocionale, psiqike apo vuajtje. Forma tjetër mund të jetë ajo e cila del në pah, dominimi i burrit dhe pozita inferiore e gruas në familje. Dhuna psikologjike mund të ndodhë në çdo ambient, si: vendi i punës, shoqëri, familje etj. Ajo mund të llogaritet si formë abuzimi kurse dhunuesi shpesh përpiqet që ta mbaj viktimën si pronë duke e detyruar të heshtë.²⁷

Dhuna psiqike përfshin injorimin e ndjenjave të bashkëshortes/it, kritika të vazhdueshme, kundërshtim i vazhdueshëm i mendimeve, poshtërim në publik ose privatisht, përpjekje për ta bindur partneren se dhunën e meriton nga veprimet e veta, kërcënim i partneres për tradhti bashkëshortore, shenja xhelozie të vazhdueshme, kërcënimin për marrjen e fëmijëve, mbajtje fshehur e parave, mbajtje në shtëpi pa punë, abuzim me fëmijët, thirrje

²⁴ Autor: Adem Tamo, Theodhori Karaj, Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri, Qendra e zhvillimeve humane, Raport studimor i financuar nga UNICEF, Tiranë, 2006

²⁵ Po aty.

²⁶, Autor: Bistra Netkova Ciceron për anëtarët e odës së avokatëve e cila u siguron ndihmë juridike viktimave të dhunës në familje, Shkup, 2010,

²⁷ <https://esem.org.mk/en/pdf/Publikacii/Ostanati/2008/-fq.4>

me emra poshtërues etj.²⁸ Shumica e abuzimeve psikologjike ndodhin në kontekstin e formave të tjera të abuzimit, si ai verbal, ekonomik dhe izolimi social. Personat që ushtrojnë abuzim fizik, zakonisht ushtrojnë edhe abuzim psikologjik. Dhuna psikologjike, për vetë natyrën e saj, është shumë e vështirë për t'u evidentuar, pasi nuk lë gjurmë të dukshme, si dhuna fizike, mirëpo sulmet verbale, poshtërimi, kërcënimi, kufizimi mund të jenë edhe më të dëmshme se sulmi fizik.²⁹ Dhuna psikike (emocionale) përfshinë edhe talljet, kërcënimet, ndjekjen nga pas, mohimin e hapësirës për të marrë vendime, ndalimi për të dalë me shoqërinë apo dhe për të dalë vetëm, kritikën e vazhdueshme ndaj kulturës apo zakoneve, sharjet ndaj viktimës në shtëpi dhe në publik, ngarkimin me faj të viktimës për çdo gjë që shkon keq, kontrollin ndaj veshjes dhe gardërobës, etj.³⁰ Forma më e shpeshtë e dhunës psikologjike në shtetin tonë është kontrolli i lëvizjes dhe kontaktet që i realizon gruaja. Si viktimë e kësaj forme të dhunës psikologjike shfaqet çdo e treta grua (36,5%). Forma e dytë sipas përfaqësimit të dhunës psikike është ajo nëpërmjet të cilës del në pah dominimi i burrit dhe pozita inferiore e gruas në familje, përkatësisht „fjala e tij (burrit) duhet të jetë e fundit” (28%). Çdo e katërta grua (25,6%) ka paraqitur se bashkëshorti/partneri sillet keq me atë apo përsëri është shumë xheloz (23,5%).³¹

2.3 Dhuna seksuale

Dhuna seksuale në kuptimin e dhunës në familje përfshinë marrëdhënie seksuale me forcë, trajtimin e partneres si objekt seksual, detyrimin për të bërë seks pa dëshirën e partneres, detyrimin për të realizuar seks në forma të padëshiruara dhe të papranueshme për partneren, këmbënguljen për të prekur e për të bërë gjithçka që dëshiron partneri, detyrimin për të bërë seks me një partner tjetër në sy ose jo të vetë bashkëshortit/partnerit, realizimi i marrëdhënieve seksuale me një partnere tjetër në sy të bashkëshortes , deklarimi për një lidhje jashtëmartesore, detyrimi për të kryer marrëdhënie seksuale pas ushtrimit të dhunës fizike, detyrimi për të bërë prostitucion, detyrimi për të bërë striptizëm, etj.³²

²⁸ Dhuna në familje, Përgjegjësitë që ka policia e shtetit për parandalimin dhe reduktimin e saj, UNDP/Japan WID Fund Support, Tiranë, 2008

²⁹ Dhuna në familje, Përgjegjësitë që ka policia e shtetit për parandalimin dhe reduktimin e saj, UNDP/Japan WID Fund Support, Tiranë, 2008

³⁰ Qendra e Aleancës gjinore për zhvillim, Raporti: Dhuna në familje: paraqitje e situatës aktuale, Tiranë, 2006

³¹ Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, Hulultimi: Jeta në hije, Shkup, 2007

³² Qendra e Aleancës gjinore për zhvillim, Raporti: Dhuna në familje: paraqitje e situatës aktuale, Tiranë, 2006

Dhuna seksuale është problem serioz i shëndetësisë publike që i prek miliona njerëz çdo vit në të gjithë botën. Ajo inicohet nga shumë faktor të cilët funksionojnë në kontekste sociale, kulturore dhe ekonomike. Kënaqësia seksuale nuk është e vetmja ajo e cila e rezulton kryerësin në këtë dhunë por edhe ajo që shpeshherë ai të dominojë dhe të tregoj fuqinë mbi personin e sulmuar.

Këtë definicion të dhënë, Organizata Botërore e Shëndetësisë e zgjeron duke shtuar këtu edhe infektimin e dikujt me sëmundje seksualisht të transmetueshme apo refuzimin e seksit me mbrojtje: “dhuna seksuale në familje paraqet çdo abuzim të natyrës seksuale që ndodh në kuadër të raportit me partnerin intim apo raportit familjar. Kjo mund të përfshijë detyrimin e dikujt që të marrë pjesë në akte seksuale kundër dëshirës së tij, refuzimin e pasjes së seksit me mbrojtje (seksit të sigurt), infektimin e dikujt me sëmundje seksualisht të transmetueshme, apo ekspozimin e materiale të natyrës seksuale pa pajtimin e tij/saj³³

Kjo formë e dhunës në shumë viktima shprehet e njejtë, por dallon në disa pikëpamje, si psh: për shumë gra të reja dhuna seksuale fillon qysh në fëmijëri dhe në adoleshencë. Në disa vende deri në 1/3 e vajzave adoleshente paraqesin marrëdhënie seksuale të parë të detyruar. Nuk dihet shkalla e vërtetë e dhunës seksuale, edhe pse të dhënat e disponueshme sugjerojnë se 1 nga 4 gra gjatë jetës së tyre mund të përjetojnë dhunë seksuale nga partneri i tyre intim. Përdhunimi shfrytëzohet si armë luftarake dhe është e dokumentuar në shumë konflikte si atë në: Bangladesh, Bosnjë dhe Hercegovinë, Indonezi, Liberi, Ruandë dhe Ugandë.³⁴

Pasojat e dukshme që pasojnë nga kjo formë e dhunës janë: shtatzëni e padëshiruar, komplikime gjinekologjike, sëmundje seksualisht të transmetueshme, depresion, çrregullime mendore etj. Faktorët të cilët rrisin rrezikun për përdhunime tek burrat janë: përdorimi i alkoolit dhe drogës, mungesa e inhibitorëve për shtypjen e asociacioneve ndërmjet seksit dhe agresionit, rritja e keqe nëpër mjedise familjare, besime të gabuara (fantazitë), shoqëria e gabuar etj. Përpyekjet të cilët mund të bëhen për të parandaluar këtë formë të dhunës mund të përmendim: përkrahja e viktimave, ndryshimin e ligjeve dhe politikave, programe edukative të ndryshme etj.³⁵

³³ Preventing intimate partner and sexual violence against women: taking action and generating evidence, Geneva, World Health Organization, 2010.

³⁴ Po aty

³⁵ OBSH, Ministria e Shëndetësisë së RMV, Enti Republikan për mbrojtje shëndetësore, fondacioni institucional i hapur i shoqërisë civile në Maqedoni, UNICEF

Gratë ende janë të papërgatitura që të flasin për dhunën seksuale, për çka flet edhe e dhëna se çdo e treta grua (32,6%) nuk i është përgjigjur pyetjes për shpeshësinë e këtij lloji dhune. Shumica, (27,8%) e grave kanë thënë se integriteti seksual - u është shkelur tre deri në dhjetë herë në suazat e familjes. Shumë ndikues është fakti, sipas të cilit, 13,2% e grave kanë paraqitur dhunë seksuale mbi 20 herë. Shqetësues është edhe niveli i ulët i paraqitjes së dhunës seksuale, sidomos kur dimë, se 43% e viktimave të dhunës kanë deklaruar se pas dhunës fizike shpesh ka pasuar marrëdhënia seksuale, e cila gjithsesi nuk ka qenë me dëshirë. Kjo flet se gratë janë të ballafaquara njëkohësisht dhe me dhunën fizike dhe me dhunën seksuale, dhe se në realitet dhuna seksuale është mjaft më e përfaqësuar se ajo sa kanë paraqitur gratë (10,6%).³⁶ Në vendin tonë, sipas një hulumtimi të bërë nga ESE, forma dominuese e dhunës seksuale është marrëdhënia seksuale pa mëshirë. Atë e kanë paraqitur 85.5% e grave-viktima. Marrëdhënia seksuale poshtëruese është paraqitur në 6.6%, kurse përdhunimi në 3.9% të rasteve. Më pak të përfaqësuar janë detyrimi dhe shikimi me dhunë i filmave pornografikë. Edhe pse këto format e fundit të dhunës familjare janë më pak të përfaqësuar (gjithsej 13,8%), ato në thelbin e vet përbëjnë shkelje të rënda të dinjitetit të gruas.³⁷

2.4 Dhuna financiare

Dhunë ekonomike ose financiare konsiderohen sjelljet që mohojnë të drejtën e individit për të pasur dhe gëzuar një pavarësi ekonomike, pavarësi që mund të krijohet nëpërmjet punës së drejtpërdrejtë në tregun e punës apo aktivitete dhe kontribute të tërthorta. Izolimi i gruas, detyrimi për të mos u punësuar apo për të ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe shfrytëzimi i kësaj situate për të rritur kontrollin dhe pushtetin mbi gruan janë shprehje të kësaj forme dhune.³⁸

Në një mënyrë apo një tjetër mund të themi se dhuna financiare merr peshë në një shoqëri, shoqëri e cila gjithnjë e më shumë është e shqetësuar për gjërat materiale. Gratë janë më shumë të prekura apo të ekspozuara ndaj këtij abuzimi që ju bëhet, kjo vlen të theksohet

³⁶ Hulumtimi: Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, Jeta në hije, Shkup, 2007

³⁷ Hulumtimi: Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, Jeta në hije, Shkup, 2007

³⁸ <https://www.slideshare.net/erginushi/stop-dhuna>

se ndodh pikërisht brenda martesës. Mund ta quajmë edhe si abuzim ekonomik, për arsye se ky lloj agresioni nuk tipizohet nga asnjë ligj por është parë tek pjesa ekonomike. Kush e lejon këtë, kush është përgjegjës në mes të kësaj situatë? Gruaja si viktimë e dhunës financiare mund të jetë edhe përgjegjëse përshkak të tolerimit të veprimeve të bashkëshortit të saj. Burrat në këtë rast janë të papunë, dhe kjo i bën ata të kenë kontroll mbi paratë apo gjendjen financiare.

Dhuna ekonomike përfshin:

- Kontrollin e parave;
- Forcimi për të vjedhur ose shitur gjëra të vlefshme;
- Mohimi i mundësisë që pasuria të jetë edhe në emër të partneres/bashkëshortes;

KAPITULLI II

2. Pikëpamje e veçantë mbi gratë dhe fëmijët si viktimat të dhunës në familje

Nuk ka dyshim se viktimat e parë e dhunës në familje është vetë gruaja që e përjeton atë. Studimet mbi këtë problem tregojnë se gruaja reagon në forma të ndryshme ndaj dhunës në familje. Shumica prej tyre reagojnë duke fajësuar vetveten për dhunën në familje. Ato gjithmonë besojnë se mund ta kishin shmangur nevrifikosjen e partnerit të tyre. Ato harrojnë ose nuk duan të besojnë se bashkëshorti violent do të gjejë një arsye tjetër për t'i dhunuar ato. Është e kuptueshme që mbartin shumë stres mbi vete duke u përpjekur të kontrollojnë sjelljet e tyre duke kënaqur burrat.

Një grup tjetër i grave të abuzuara ndjehen të pashpresa në situatën që ndodhen, sepse ato mendojnë se dhuna në familje është pjesë e jetës bashkëshortore. Viktimat kanë parë të njëjtin model me nënat e tyre dhe kanë dëgjuar se edhe gjyshet e tyre nuk kanë qenë më mirë. Kështu, ato e konsiderojnë dhunën si pjesë të jetës së tyre.

Grupi i tretë i grave të dhunuara, sipas studiuesve, sjellim në vëmendje studimin Uolker në vitet 1979-1982, fillojnë të nënvleftësojnë vetveten dhe mendojnë se ato nuk janë të përshtatshme për partnerët e tyre, ato besojnë se nuk kanë vlera, nuk janë të zonjat të jenë produktive dhe e vendosin veten në pozicion varësie. Gratë tjera reagojnë duke u ankuar për sjelljet e burrave të tyre, fillimisht midis familjarëve dhe më pas, në rastet e dhunës së

përsëritur, ato kërkojnë ndihmë tek specialistët. Të tjera gra reagojnë duke u larguar nga shtëpia dhe duke kërkuar strehim tek familjarët apo në strehëzat për gratë. Disa të tjera fillojnë të kenë probleme të shëndetit mendor dhe bëhen të varura tek anëtarë të tjerë të familjes duke e përkeqësuar situatën më tej. Në çdo rast, secila grua e abuzuar gjen mënyrën e saj të reagimit ndaj dhunës, gjë që varet nga niveli i ndërgjegjësimit, i arsimimit, aftësia për të luftuar në mbrojtje të vetvetes, mbështetja që merr nga familja e origjinës, situata ekonomike, mbështetja nga fëmijët, informacioni që ajo ka mbi shërbimet sociale ekzistuese, etj. Nuk është e vështirë të kuptohet se gra të mbushura me kaq ndjenja negative nuk janë në gjendje të menaxhojnë normalisht për veten e tyre. Ato nuk janë në gjendje të marrin vendime të sakta në situatat e vështira ku ndodhen, nuk mund të mendojnë drejt, nuk janë në gjendje të drejtohen tek burimet e duhura për mbështetje, nuk mund të plotësojnë nevojat e tyre dhe mund të bëhen dhunuese të fëmijëve të tyre.³⁹

Fëmijët ndikohen nga dhuna po aq sa dhe nënat e tyre, madje, ndonjëherë edhe më shumë. Niveli i zhvillimit të tyre psikologjik nuk i lejon të kuptojnë situatën e dhimbshme në familje. Ata ndërmarrin rol të rëndësishëm në familje si kujdesi për motrat dhe vëllezërit më të vegjël. Fëmijët marrin përgjegjësinë për t'i bërë të lumtur prindërit e tyre dhe përpiqen të bëjnë gjëra që t'i bëjnë ata të ndjehen mirë. Gjithashtu janë të prirur të ndërpresin kontaktet me shokët e tyre sepse kanë dyshime që incidentet e dhunshme mund të ndodhin në prezencën e tyre. Të miturit dëshmitar të dhunës në familje, izoloohen në një moshë të hershme dhe janë të rrezikuar të marginalizohen edhe më tej në shoqëri. Ndërkohë që përjetojnë dilemën nëse duhet ta duan dhunuesin e nënës së tyre apo duhet ta urrejnë atë. Për pasojë, fëmijët që rriten në ambiente të dhunshme kanë tendencën t'i kthehen dhunës si metodë për zgjidhjen e problemeve kur të jenë në moshë madhore⁴⁰. Studiues amerikanë, Sheldoni dhe Eleanor Glueck kanë marrë në studim dy kampione ku njëri prej tyre përmbante 500 autorë të veprave penale dhe kampioni tjetër me 500 subjekte të padënuar ndonjëherë. Nga ky studim rezulton se 50% e të dënuarve vinin nga familje të cilat kishin prodhuar dhunë ndërsa 29% me natyrë jo delikente⁴¹. Së fundmi, por që nuk është më pak e rëndësishme, këta fëmijë shumë shpejt fillojnë të shfaqin vështirësi në procesin e të mësuarit. Atyre ju mungon vëmendja, nuk studiojnë mjaftueshëm, humbasin dëshirën për shkollim, bëhen pasivë në klasë, largohen nga orët e mësimi si dhe kanë fjalor të kufizuar. Duke qëndruar në një mjedis të dhunuar, stepen të kërkojnë ndihmë, nuk dinë të ankohen, mbyllen në vetvete,

³⁹ <https://www.slideshare.net/erginushi/stop-dhuna>

⁴⁰ Hollin, C: Social learning theory, " The sage Dictionary of Criminology", Sage, 2001, fq 279-281

⁴¹ Gelles R. Family : "Family violence", Oxford, 1998, fq 196

rriten para kohe, nuk kanë besim tek njerëzit që i rrethojnë, kanë çrregullime të të ngrënit, kanë probleme me urinimin dhe përgjithësisht kanë çrregullime të të mësuarit dhe jo pak herë karakterizohen nga një fjalor i varfër dhe vulgar deri sa arrijnë tek momenti i braktisjes totale të shkollës⁴². Në meta-analizen e studimeve mbi efektet që ka dhuna tek fëmijët kur ata rriten, Ëegman dhe Stetler ndër të tjera shkruajnë: “Efekti i abuzimit të fëmijëve në shëndetin e të rriturve ishte më i madh në studimet me kampion ekskluzivisht femra në krahasim me studimet që përfshinin të dyja gjinitë. Ky rezultat duhet të interpretohet me kujdes të madh, sepse përbërja gjinore e studimit mbi abuzimin ndaj fëmijëve nuk pasqyron prevalencën e abuzimit për meshkujt dhe femrat në popullatën e përgjithshme.

Mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna qoftë edhe në familje dhe definimin e kësaj dhune e proklamon edhe Konventa për të drejtat e fëmijës. Ajo në nenin 19 obligon shtetet nënshkruese që: “duhet ti ndërmarrin të gjitha masat adekuate legjislative, administrative, sociale dhe edukative për të mbrojtur fëmijët prej të gjitha formave të dhunës fizike apo mendore, lëndimeve apo abuzimeve, trajtimit me neglizhencë, maltretimi apo eksploatimi, duke përfshirë këtu edhe keqpërdorimin seksual, qoftë derisa janë nën përkujdesjen e prindit/ve, kujdestarit apo personit tjetër që duhet të kujdeset për fëmijën.”⁴³

Dhuna zakonisht është e fshehur. Fëmijët nuk janë në gjendje të raportojnë aktet e dhunës për shkak të frikës nga dhuna. Ndoshta të dy, si fëmija ashtu edhe dhunuesi nuk shohin asgjë të pazakonshme apo gabim që fëmija është subjekt i dhunës. Ata ndoshta nuk konsiderojnë se akti i dhunës është faktikisht dhunë, ndoshta e shohin atë si dënim të arsyeshëm dhe të merituar. Kjo shpesh bën që fëmija të mos të dëshirojë të flasë për këtë.⁴⁴

Ndonëse shumica e studimeve të tashme të meta-analizës përfshijnë vetëm femrat në kampionet e tyre, meshkujt kanë po aq të v ngjarë si edhe femrat që të përjetojnë abuzimin, mbase edhe më shumë se to. Djemtë kanë më shumë gjasa të jenë viktimat të abuzimit të rëndë fizik, abuzimit psikologjik, dhe neglizhencës, ndërsa vajzat kanë më shumë⁴⁵” Çdo keqtrajtim i fëmijës mund të shkaktojë pasoja të dëmshme dhe të pakthyeshme, megjithatë, studimet tregojnë se kur kjo bëhet në mënyrë kronike dhe të përsëritur fëmija përjeton pasoja

⁴² www.stopvaw.org/Effects_of_Domestic_Violence_on_Children.html 183 gjasa të jenë viktimat të abuzimit seksual

⁴³ Konventa për të drejtat e fëmijës, Rezoluta e Asamblesë së përgjithshme e OKB-së 44/25, 20.11.1989

⁴⁴ http://www.unicef.org/protection/index_violence.html, vizituar më: 18.08.2011

⁴⁵ Holly L. Wegman, Cinnamon Stetler, A Meta-Analytic Review of the Effects of Childhood Abuse on Medical Outcomes in Adulthood, Shoqata Amerikane e Psikosomatikës

edhe më të rënda⁴⁶. Abuzimi i fëmijëve dhe neglizhenca mund të ndikojnë në të gjitha fushat e zhvillimit - fizike, psikologjike, njohëse, të sjelljes dhe ato sociale – të cilat janë shpesh të ndërlydhura. Studimet e pakta shkencore në Shqipëri mbi dhunën ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve tregojnë se “Format më të shpeshta të dhunës fizike në shtëpi dhe në shkollë janë ato me goditje dhe përkatësisht: një në dy fëmijë goditen në kokë e trup në shtëpi, ndërsa një në tre goditen edhe në shkollë. Kjo do të thotë se në shtëpi fëmijët përjetojnë më shumë akte të dhunës fizike sesa në shkollë⁴⁷.” Gjithashtu, një pjesë e studiuesve kriminologë mbajnë qëndrimin se, të miturit të cilët janë rritur nën përkuqjesjen e vetëm të një prindi⁴⁸ kanë më shumë tendenca delikuede sesa të miturit e rritur nga të dy prindërit. Megjithatë, ky faktor nuk mundet të merret i mirëqenë, pasi ka kontradikta në rezultatet që nxjerrin studimet lidhur me të. Studiuesit Rosen dhe Neilson në mënyrë të vazhdueshme raportojnë nga hulumtimet e tyre se nuk ka “asocim mes prindit të vetëm dhe delikuencës⁴⁹” Ekzistojnë një sërë studimesh në këtë fushë, të cilat mbështesin tezën se rritja e fëmijës nga një prind i vetëm nuk përbën diçka patologjike por një strukturë ë tillë familjare mund të favorizojë më tepër delikuencën e të miturit. Për pasojë, vlerësohet si nevojë ndërtimi i politikave sociale për të monitoruar autonominë e pakontrolluar të këtyre fëmijëve.

2.1 Studim i përgjithshëm mbi gratë në rrethinën e qytetit të Gostivarit mbi arsimimin

Për të krijuar një ide sa më të qartë rreth asaj që quajmë “ ngritje arsimore e femrës “ duhet të gërmojmë thellë në historinë e njerëzimit për të ndjekur më pas kronologjikisht rolin e femrës në shoqëri që në periudhat e hershme të ekzistencës humane. Nëse pyesim për lindjen dhe zhvillimin e trajtimit të pabarabartë të grave, në përgjithësi marrim përgjigjen se kjo duhet kërkuar në rrënjët e patriarkatit. Ideja se shoqëria patriarkale - me gjithë shkallëzimet dhe formësimet e ndryshme - ka ekzistuar gjithnjë, vazhdon të qëndroj kokëfortë. Megjithatë, shkencëtarët gjatë dekadave të fundit, kanë paraqitur një pamje tjetër të zhvillimit historik. Shumë dëshmi tregojnë se në kohën e neolitit, pra, para rreth 7000

⁴⁶ Arata, C. M., Langhinrichsen-Rohling, J., Bowers, D., & O’Farrill-Swails, L. (2005). Single versus multi-type maltreatment: An examination of the long-term effects of child abuse. *Journal of Aggression, Maltreatment & Trauma*, 11(4), 29-52.

⁴⁷ Adem TAMO, Theodhori KARAJ, Dhuna kundër Fëmijëve në Shqipëri, Qendra e Zhvillimeve Humane dhe Unicef, Tiranë 2006

⁴⁸ Të njohura si “single parent families” sipas Kevin N. Wright dhe Karen E. Wright, *Family Life and Delinquency and Crime*, viti 1993, fq 6

⁴⁹ Po aty, fq 7

vjetësh, kultura të zhvilluara të punimit të arave popullonin vise të Evropës dhe Azisë së Vogël. Në këto shoqëri, gratë luanin një rol të rëndësishëm: nga ana ekonomike si punëtore të arave dhe nga ana fetare si udhëheqëse shpirtërore në adhurimin e hyjnive. Linja e trashëgimisë ka të ngjarë të ketë qenë matrilineare, pra nga nëna te vajza. Burrat kishin pozita të rëndësishme si artizanë dhe tregtarë, ndërsa luftëra duket se nuk ka pasur.⁵⁰

Shkollimi dhe emancipimi i femrës shqiptare, ishte një detyrë e vështirë por shumë e rëndësishme. Prapambetja e madhe që e karakterizonte vendin tonë në atë kohë, rëndonte më së shumti gratë, të cilat i nënshtroheshin një shtypjeje e skllavërimit të shumëfishte nga klasat shfrytëzuese dhe nga zakonet prapanike të kanuneve të vendit. Kushtet e reja ekonomike, shoqërore e politike, e shtruan nevojën e përhapjes të lexim-shkrimit, si armë e parë, që do ti hapte femrës rrugën e kulturës dhe të emancipimit.⁵¹ Në vjeshtën e vitit 1941, respektivisht më 16 tetor 1941 u hap në mënyrë solemne shkolla e parë në gjuhën shqipe me emrin Naim Frashëri, në Gostivar. Në vitin e parë shkollor, në këtë shkollë u regjistruan 477 nxënës, prej të cilëve **363 meshkuj dhe 114 femra.**⁵²

Më vonë, edhe në vitet në vazhdim, regjistrimi i nxënësve ishte po në atë numër minimal të femrave në dallim me meshkujt. Vlen të theksohen, mësueset dhe mësuesit, në këndvështrimin e tyre historik, kanë kontribuar në fushën e arsimit, në të gjitha trevat shqiptare. Ata ndikuan dukshëm në emancipimin e femrës, në periudha të ndryshme kohore dhe merita e tyre është e pamohueshme.⁵³

Të parët tanë, mësimdhënësit të cilët kanë dhënë kontributin e tyre rreth emancipimit të femrës apo gruas shqiptare, megjithatë kanë ndodhur dallime apo përjashtime midis gjinive, në këtë rast duke përjashtuar gruan.

Termi “përjashtim social” përfaqëson një proces dhe gjendjen si rrjedhojë e procesit. Përkufizimi i studiuesit Trevor Bradley thotë se “përjashtimi social” i referohet procesit dinamik dhe dimensioneve të shumta të përjashtimit të plotë ose të pjesshëm nga sistemet e ndryshme sociale, politike ose kulturore të cilat shërbejnë për të integruar individin në shoqëri.⁵⁴ Në të njëjtën kohë koncepti lidhet edhe me marginalizimin, varfërinë, izolimin social dhe pozitat e dobëta të individëve të prekur dhe mungesa e gëzimit të “qytetarisë” së

⁵⁰ Punim, Argjira Ukimeri, Prizren 2011, <http://www.albaniapress.com/lajme/13822/NGRITJA-ARSIMORE-E-FEMRES.html>

⁵¹ Prof. Rasim Gashi, Mësuesja e parë në Gostivar, 2011

⁵² Po aty

⁵³ Po aty

⁵⁴ Bradely, T, Përjashtimi social te Fjalori i kriminologjisë, Sage, Londër, 2001, f. 275.

plotë⁵⁵. Në këto rrethana, gratë si viktimat të përjashtimit social ridimensionohen duke konsumuar vepër penale. Shumica prej tyre nuk ka përfunduar arsimin e detyrueshëm për arsye të ndryshme familjare. Një pjesë e tyre nuk kanë asnjë formim profesional dhe kanë përjetuar varfërinë apo kushtet e mbijetesës në familje që në adoleshencë. Të tjera janë përballur me xhelozinë, kryesisht të bashkëshortëve të tyre që nuk i kanë lejuar të dalin në komunitet, për më tepër, e kanë pasur të pamundur të ishin pjesë e tregut të punës. Nga ana tjetër, prindërit, të afërmit apo miqtë kanë qëndruar në heshtje lidhur me pasivitetin e detyruar dhe izolimin e gruas. Mungesa e vëmendjes së autoriteteve shtetërore, prindërve, të afërmeve, miqve por edhe paaftësia për të reaguar rrit tensionin e të dhunuarës. E për pasojë, e ndër e përjashtuar nga shoqëria kundërpërgjigjet në disproporcion me kontekstin e krijuar duke konsumuar vepër penale.

2.2 A ndikon dhe si shkalla e arsimimit tek viktimat si pasojë e dhunës në familje?

Çdoherë kur flasim për viktimën si pasojë e dhunës në familje, gjëja e parë që mendojmë është femra dhe fëmijët, por nuk duhet përjashtuar edhe fakti se dhe meshkujt janë viktimat të dhunës në familje në raste të rralla. Nga ky këndvështrim kuptojmë se, ndryshimi i gruas ishte konceptuar së pari, nga arsimimi. Arsimimi të çon tek puna. Puna të jep të drejtat. Të drejtat të lejojnë zgjedhjet. Lëvizja feministe në vitet '30-të të shekullit të XX-të, lindi vetëm nga një mundësi: arsimimin. Kjo ishte rruga e vetme, që shpjegonte pafuqinë trashëgimore të shoqërisë shqiptare të kohës. Gruaja nuk gëzonte të drejtën e shkollimit, por frenimi i kësaj të drejte ishte i qëllimtë. Kundër këtij presioni social, mjaft prej tyre u arsimuan. Ishte origjina familjare që ua mundësoi shkollimin. Të kthyer në atdhe nga vendet e huaja, ato kuptuan rolin e letërsisë dhe të mendimit letrar në ndryshimet sociale, si përfaqësuese të denja të emancipimit të jetës shoqërore, kundërshtarë ndaj pengesave dhe imponimeve kanunore, sidomos mbi jetën, martesën dhe familjen.⁵⁶

⁵⁵ Levay, M., Përjashtimi social: Një koncept në lulëzim në kriminologjinë bashkëkohore; Përjashtimi social dhe krimi në Europën Qendrore dhe Lindore të "Politikat penale, reformat në drejtësi dhe përjashtimi social", publikimi nr. 48 i Institutit Europian të Parandalimit dhe Kontrollit të Kriminologjisë, HEUNI, Helsinki, 2007, f. 7.

⁵⁶ https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/09/Ezmeralda_Xheraj.pdf

2.3 Fëmijë të shëndoshë apo me sëmundje të ndryshme si viktime të dhunës në familje?

Ndër format më të shprehura të dhunës kriminale në shoqërinë bashkëkohore konsiderohet edhe dhuna ndaj fëmijëve ose të miturve, qoftë brenda familjes, qoftë jashtë saj. Kjo dhunë mund të manifestohet si dhunë fizike, psikike dhe seksuale. Për shkak të dukurisë shumë të përhapur të dhunës ndaj fëmijëve, në tërë botën bashkëkohore tani bëhen përpjekje që kjo dukuri mos të ngel në sferën e brendshme familjare por të bëhet çështje e përgjithshme publike, me qëllim të eliminimit të të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre.⁵⁷

Autorë të ndryshëm, me të drejtë konstatojnë se përmasat, vëllimi dhe pasojat e kësaj dhune, është vështirë të përcaktohen dhe vërtetohen me saktësi. Kjo për arsye se format e ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve ngelin të pa regjistruara dhe të paevidentuara, ngase konsiderohen si çështje intime familjare. Këto dukuri të shkeljes së të drejtave dhe lirive të fëmijëve, e veçmas aktet e dhunës ndaj tyre, shpesh ngelin larg syve të opinionit, larg veshëve të organeve dhe institucioneve shtetërore të cilat do të duhej ti mbronin dhe shpëtonin fëmijët nga kjo dhunë. Për këtë arsye, veprimet kriminale të dhunës ndaj fëmijëve, ***në të shumtën e rasteve nuk paraqiten fare ose në numër shumë të vogël.***⁵⁸

Pasojat më alarmante e dhunës fizike ndaj fëmijëve është vdekja. Shpesh nënvlerësohet mundësia që dhuna fizike mund të shkaktoj vdekje. Sipas të dhënave ekzistuese, OBSH-ja përllogarit se deri 53,000 fëmijë vriten çdo vit në botë.⁵⁹

Edhe pse dhuna tek fëmijët mund të shkaktoj vdekje, janë më të larta mundësitë që mund të shkaktoj dëmtime. Dëmtimet në fëmijëri mund të jenë shumë të rrezikshme pasi zhvillimi konjitiv dhe fizik është i vazhdueshëm. Dëmtimet e rënda në tru mund të jenë shkak dhe pasojë e dhunës. ***Nga një anë, fëmijët me aftësi të kufizuara janë më të cënueshëm dhe në rrezik më të lartë dhune.*** Nga ana tjetër, dëmtimet serioze rrisin rrezikun për paaftësi të përhershme. Pra, krijohet një rreth vicioz. Duhet të gjendet lidhja edhe midis aftësive të kufizuara dhe gjasave për të lindur tek një familje abuzive ku mundësitë për dhunë në familje janë më të larta.⁶⁰

⁵⁷ Dr.Ragip Halili -Kriminologjia,-Prishtinë 2002

⁵⁸ Dr.Ragip Halili -Kriminologjia,-Prishtinë 2002

⁵⁹ childhub.org, who.int – World Health Organization

⁶⁰ Po aty

Pas disa hulumtimeve dhe kërkesave në Entin Social në qytetin e Gostivarit, sa i përket kësaj pike që ne i jemi referuar, dolëm në një konkludim se rastet e dhunës në familje sa u përkasin fëmijëve si viktima, paraqiten shumë rrallë ose thënë më saktë aspak.

Me aq sa arritëm të gjejmë, vetëm në vitin 2015 ishte i evidentuar 1 rast edhe atë e paraqitur nga ana e nënës, kurse vitet tjera hulumtuese të punimit ngelen me 0 raste të paraqitura.

Këto statistika nuk janë tregues real të gjendjes faktike në qytetin tonë, sepse mendoj që për shkak të moshës së tyre, fëmijët vështirë marrin guximin të paraqesin dhunën e ushtruar nga ana e prindërve. Kjo dhe për arsyen e faktit real që ekziston jo vetëm në komunën e Gostivarit por edhe në shumë komuna tjera, që është mungesa e institucioneve strehuese dhe rehabilituese.

Gjithashtu mund të konkludoj se nuk duhet me patjetër të ushtrohet dhunë fizike ndaj fëmijut por me vet faktin që ushtrohet dhunë nga njëri prind ndaj tjetrit në mënyrë indirekte dhunohet emocionalisht dhe psiqikisht fëmiju.

2.4 A luan rol mosha e fëmijëve të prekur si viktima të dhunës në familje dhe në bazë të saj a dallon vepra penale që i prek ato?

Një numër i madh i hulumtimeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e hershëm të fëmijëve konfirmojnë se përvoja me të cilën ballafaqohen gjatë fëmijërisë së hershme paraqet moment kritik për suksesin afatgjatë në përgjithësi në jetë.

Mosha tek fëmijët normal që është shumë delikate në çdo fazë të saj dhe përmban ato karakteristikat dhe të veçantat e veta. Kur flitet për ambiente familjare të dhunshme, pa marrë parasysh moshën çdo fëmijë e pëson negativisht në mënyrën e vet.

Nëse krahasojmë një moshë shumë më të vogël të fëmijëve të prekur si viktima, qofshin ato viktima të prekur në mënyrë direkte apo indirekte, mund të themi lirisht që e pësojnë më rëndë për shkak të mos dijes së reagimit në ato momente apo thënë ndryshe nuk arrin të kuptoj skenën dhe si ta përballoj atë.

Nuk kemi të dhëna të specifikuara sa i përket moshës së fëmijëve si viktime të dhunës në familje, si dhe nuk dihet apo nuk është e saktë të finalizojmë përgjigjen e pyetjes, nëse dallon vepra penale në bazë të moshës.

Sipas vlerësimeve të mia, për këtë pikë hulumtimi mund të them që ndoshta fëmijët në moshë më të vogël deri 12 vjeç, janë të predisponuar të përjetojnë dhunë fizike, ngase në këtë moshë ata nuk mund apo kanë frikë të ndalojnë dhunuesin për shkak të aftësisë së tyre të dobët fizike, kurse fëmijët deri në moshën 18 vjeç janë më të pjekur dhe në një farë mënyre e kuptojnë situatën dhe mund ta menaxhojnë atë.

Për arsye të mungesës së informacioneve, bëra këtë pyetje në një sondazh, ku më poshtë do të shohim disa nga replikat më të mira:

“ Mendoj se po, sepse kur fëmijët janë në një moshë relativisht të vogël e kanë të pamundur për tu bërë balle rasteve të tilla, e kanë të vështirë të stopojnë dhunën në familjen e tyre. Shpesh janë ato që dhunohen jo vetëm me dhunë fizike por edhe atë psikologjike, të detyruar për të duruar atë skenë.”

“Mosha luan një rol të madh për mendimin tim, kur ka dhunë në familje, fëmijët nuk janë në gjendje të bëjnë padi tek policia për arsye frike, mentaliteti, turpi, etj.”

“Mosha e viktimave të dhunës ndikon në impaktin që le tek brezat sepse ata janë e ardhmja që dashur padashur ndodh të trashëgojnë këtë dhunë. Por përveç kësaj, fëmijët nuk janë të aftë të vetëmbrohen dhe ndoshta ky fakt merret në konsideratë në gjykimin e dhunuesit.”

“Po, mosha luan rol pas gjinisë, më të prekurit nga format e ndryshme të dhunës në familje janë gruaja dhe fëmijët e mitur. Vepra penale ndaj kësaj kategorie dallon, dhe ne Kodin Penal dallon si vepër penale e kryer ndaj personave vulnerabil ndër të cilët ekzistojnë lidhje familjare, ose marrëdhënie kujdestarie.”

“Aspak. Fëmijët dhunohen në cdo formë të mundshme në cdo moshë, kurdo dhe kudo.”

“Po luan rol. Mendoj që fëmijët nën moshën 14 vjec e përjetojnë më keq dhunën sepse është mosha kur fillon të kuptoj më shumë rreth vetes dhe shoqërisë që e rrethon. Dhuna e ndrydh në ndjenja dhe në formimin e karakterit duke krijuar një individ ‘jo të shëndetshëm’ për shoqërinë.”

“Nuk ka lidhje mosha e fëmijëve. Nuk do të thotë së fëmija është më i vogël dhe vepra penale është më e rëndë. Edhe sikur një i rritur të jetë 20 vjec dhe të jetoj me prindërit, nese babai dhunon patjëtër që vepra penale duhet të jetë e rëndë ashtu si e një fëmije 2 vjec.”

“Po, mosha e fëmijës ndikon sepse sa më i rritur fëmija aq më shumë ka mundësi për vetëmbrojtje por kur janë të vegjël mendoj se praktikohet dhuna fizike dhe tek më të rriturit dhunë emocionale.”

KAPITULLI III

3. Mbrojtja ligjore e viktimave të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut deklaroi pavarësinë e saj nga Jugosllavia në vitin 1991. Ashtu si edhe shtetet e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, edhe Maqedonia e Veriut është një demokraci në zhvillim në procesin e zhvillimit të një ekonomie të tregut të lirë. Maqedonia duhej të kalojë një histori të gjatë të shënuar nga mungesa e traditës demokratike, vështirësive ekonomike dhe tensioneve në mes të grupeve etnike për të arritur prosperitet dhe mbrojtje më të mirë për të drejtat themelore të qytetarëve të saj.⁶¹

⁶¹ Minnesota Advocates for Human Rights, Domestic Violence in Macedonia, 1998, f.10

Në legjislacionin e vendit tonë, deri në ndryshimet legjislative në Ligjin mbi familjen në vitin 2004 nuk kishte asnjë dispozitë ligjore që rregullonte në mënyrë eksplicite dhunën në familje. Kurse, kryerësit e dhunës në familje ndiqeshin sipas dispozitave të përgjithshme penale kundër dhunës.

Sulmet penale ndaheshin në dy kategori të gjëra: sulme që shkaktojnë “lëndime trupore” dhe ato që shkaktojnë “lëndime të rënda trupore”. Sipas ligjit, për lëndime të lehta trupore ndjekja penale iniciohej me padi private nga viktimat, kurse lëndimet e rënda trupore ndiqeshin sipas detyrës zyrtare nga prokurori publik.⁶²

Nga kjo situatë ligjore në vendin tonë, mund të kuptohet edhe vështirësia ose edhe pamundësia e viktimave që të kërkojnë ndihmë dhe mbrojtje ligjore për dhunën në familje (për të gjitha format e saj) përveç rasteve kur është bërë fjalë për “lëndime të rënda trupore”. Madje, mund të konstatohet se në atë kohë, ka pasur edhe konstatime të tilla se dhuna në familje në vendin tonë nuk ekziston. Deklaratë të tillë kemi në vitin 1998 nga ana e zëvendësministrit për punë të brendshme dhe shefit të policisë së Shkupit dhënë në intervistë për avokatët për të drejtat e njeriut nga Minesota, në të cilën intervistë ata theksojnë se në Republikën e Maqedonisë dhuna në familje nuk ekziston apo edhe deklarata e Kryeprokurorit publik se midis viteve 1980 dhe 1995 zyra e tij nuk i është përgjigjur me padi penale asnjë kërkesë për sulm, madje ai shton se disa raste të sulmit të burrit ndaj gruas më së shpeshti janë zgjedhur përmes ndërmjetësimit, përmes procedurës civile të divorcit e jo përmes ndjekjes penale.⁶³

Fakti që dhuna në familje ndodh në shtëpitë private, nuk e liron shtetin nga përgjegjësia për ndalimin e saj. Shteti ka detyrim juridik që të sigurojë se ligjet ekzistuese që rregullojnë raportet martesore janë jo diskriminuese dhe të njëjtit ta inkriminojnë lëndimin e integritetit fizik, pa dallim se kryerësi a është partneri intim apo person tjetër. Shtetet kanë obligim juridik të garantojnë se viktimat e dhunës në familje kanë në dispozicion mjete juridike që i mbrojnë nga dhuna në familje dhe se kryerësit e të njëjtës janë të dënuar në mënyrë adekuate. Për këtë shkak, shteti ka për obligim që ti shfuqizojë ligjet që diskriminojnë, të sjellë ligje adekuate dhe të siguroj veprim efikas të zyrtarëve shtetëror në luftën kundër dhunës në familje.⁶⁴

⁶² Po aty f.21

⁶³ Minnesota Advocates for Human Rights, Domestic Violence in Macedonia, 1998 fq.17 dhe f.22

⁶⁴ Të drejtat e njeriut dhe dhuna në familje, Bistra Netkova, Universiteti i Evropës Jug-Lindore, 2007, f.83

Ndryshimet rrënjësore në legjislacionin tonë për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje filluan në vitin 2004 me amendamentimin dhe ndryshimin e Kodit Penal dhe Ligjit për familjen, ku u miratuan nene përkatëse që në mënyrë eksplicite kanë të bëjnë me dhunën në familje. Prej këtu edhe filluan ndryshimet rrënjësore të politikës shtetërore dhe shoqërore për njohjen pikë së pari të dhunës në familje, dënimin e kryerësve, vetëdijesimin e viktimave për denoncim të dhunës në familje, realizimin e kampanjave të ndryshme mediatike e kështu me radhë.

Me këtë ligj rregullohet veprimi i përgjegjshëm dhe i domosdoshëm i institucioneve dhe shoqatave, koordinimi dhe bashkëpunimi i tyre i ndërsjellë, për parandalim dhe pengim të dhunës në familje dhe sigurim të mbrojtjes së viktimave.⁶⁵

Qëllimi i ligjit është ndërmarrja e masave të orientuara në parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, jetës, integritetit personal, mosdiskriminimit dhe barazisë gjinore, me kujdes të plotë mbi interesat dhe nevojat e viktimës.⁶⁶

3.1 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kushtetuta është akti më i lartë juridik i një shteti. Si ligj më i lartë, si ligj themelor i shtetit, kushtetuta është bazë për realizimin dhe sigurimin e drejtësisë, bazë për harmonizimin e akteve të ndryshme juridike në atë shtet. Përveç si akt konstituiv i organeve shtetërore dhe bazë mbi të cilën ushtrohet i tërë pushteti shtetëror, kushtetuta është akti themelor me të cilin jo vetëm që proklamohen, por edhe garantohen dhe realizohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të shtetasit, si subjekt i shoqërisë, si pjesëmarrës aktiv në konstituivin dhe ushtrimin e pushtetit politik, si rezultat i së drejtës së tij natyrore.⁶⁷

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është e orientuar drejt mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ka një frymë humane dhe demokratike.

⁶⁵ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje në RMV, neni 1

⁶⁶ n Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje në RMV, neni 2

⁶⁷ E drejta kushtetuese, Libri I, Kurtesh Salju, Prishtinë, 1998, faqe 4

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë ka gjithsej IX pjesë, 134 nene.⁶⁸ Ajo është e formuluar në bazë të frymës demokratike të proklamuar nga shtetet e civilizuar. Pjesa e dytë e Kushtetutës ka të bëjë me Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe shtetasit. Ajo i trajton të gjithë qytetarët e saj si të barabartë, ku të gjithë i gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore që i takojnë njeriut. Pra, bazë themelore e sistemit kushtetues të RM-së është jo diskriminimi respektivisht barazia e të gjithëve. Në këtë aspekt neni 9 thotë: “Shtetasit e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pasurore dhe shoqërore. Shtetasit janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjit”. Ajo gjithashtu mbron jetën, integritetin fizik, moral dhe lirinë e njeriut. Jeta e njeriut është e pacenueshme (neni 10, paragrafi 1). Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacenueshme. Ndalohet çdo formë e torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzor dhe poshtërues (neni 11, paragrafi 1 dhe 2). Liria e njeriut është e pacenueshme. Askujt nuk mund ti kufizohet liria, përveç se me vendimin e gjykatës dhe në rastet dhe në procedurën e caktuar me ligj (neni 12, paragrafët 1 dhe 2). Në bazë të këtyre neneve kushtetuese janë sendërtuar dispozitat e tjera ligjore në sistemin tonë duke përfshirë këtu edhe inkriminimin e veprave penale për veprimet që janë në kundërshtim me këto nene. Kështu në Kodin Penal kemi veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, veprat penale kundër martesës, familjes dhe rinisë dhe veprat e tjera për të cilat do të flasim më poshtë.

Përveç këtyre neneve, Kushtetuta e RM-së përmban edhe disa nene që garantojnë ndihmë dhe mbrojtje për qytetarët. Fjalën e kemi për nenin 35 ku thuhet se Republika ua garanton të drejtën e ndihmës shtetasve të pafuqishëm dhe të paaftë për punë(paragrafi 2). Duke marrë parasysh rëndësinë e familjes në çdo shoqëri Kushtetuta jonë në nenin 40 thekson se Republika kujdeset dhe i siguron mbrojtje të veçantë familjes (paragrafi 1). Marrëdhëniet juridike në martesë, familje dhe bashkësi jashtëmartesore rregullohen me ligj (paragrafi 2). Paragrafi i tretë ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve dhe prindërve të moshuar : “ Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të kujdesen për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët janë të obliguar që të kujdesen për prindërit e moshuar dhe të pafuqishëm”. Ky nen ka shumë

⁶⁸ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e RM-së 52/92

rëndësi për tematikën që po e shtjellojmë, pra legjislacioni jonë duhet të mbrojtë familjen, të kujdeset për mirëqenien e saj, të kujdeset që fëmijët dhe të moshuarit të jetojnë në mirëqenie dhe rehati familjare dhe me kujdes adekuat.

3.1.1 Strategjia për parandalimin e dhunës në familje

Qëllimi kryesor i Strategjisë për parandalim të dhunës në familje është parandalimi i të gjitha formave të dhunës në familje ndaj çdo viktime, por masat të cilat i parasheh kjo Strategji ofrojnë qasje specifike që merret me nevojat individuale të viktimave. Duke pasur parasysh që si viktima më të përfaqësuara të dhunës në familje janë gratë, Strategjia ofron një kornizë për masa specifike gjinore që kryesisht përqëndrohen në parandalimin e dhunës dhe në mbrojtjen e nevojave specifike të grave, por njëkohësisht ofron edhe një sërë masash dhe aktiviteteve që mbulojnë edhe viktimat tjera. Strategjia nacionale për parandalim të dhunës në familje 2012-2015 ka për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të një sistemi gjithëpërfshirës dhe efektiv për parandalim të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë. Përpilimi i këtij dokumenti strategjik në një masë të gjerë mbështetet në Strategjinë për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011 dhe paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të qeverisë së Republikës së Maqedonisë për një zgjidhje funksionale dhe efektive për dhunën në familje. Strategjia nacionale gjithashtu është vënë në pajtueshmëri me zotimet dhe obligimet që Qeveria ka marr përsipër si përpjekje për të çrrënjësuar dhunën në familje. Njëkohësisht, Qeveria zotohet edhe ndaj qëllimeve dhe detyrave që janë përfshirë në Strategji, duke patur parasysh, mes tjerash, që zbatimi i tyre i duhur është hap thelbësor për të lidhur politikën nacionale me politikën e Unionit Evropian.

Strategjia nacionale për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje 2012-2015 është përpiluar nga një grup punues i nominuar nga Organi koordinativ nacional për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011 (OKN). Grupi punues përbëhet nga përfaqësues të institucioneve nacionale relevante, të organizatave joqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare⁶⁹. Qasja e miratuar për përpilimin e Strategjisë e cila themelohet në pjesëmarrje dhe partneritet vendos një detyrim për të gjithë personat relevant të përfshirë në zbatimin e aktiviteteve për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje në nivel nacional. Strategjia është përpiluar sipas

⁶⁹ Shih Aneksin I- Anëtarë të grupit punues

përvojave dhe mësimave të mësuara nga të gjitha institucionet nacionale, organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare në zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011. Dokumentet nacionale dhe ndërkombëtare për dhunën në familje kanë qenë një burim i rëndësishëm informatash për Strategjinë. Një vëmendje e posaçme iu përkushtua hulumtimeve shkencore për dhunën në familje në nivel ndërkombëtar dhe nacional, që mundësoi një perspektivë të çmuar. Hapi i parë gjatë përpunimit të Strategjisë ishte analiza e gjendjes momentale në lëminë e parandalimit dhe luftës kundër dhunës në familje, që përfshinte disa aktivitete: shqyrtimin e kornizës rregullatore dhe legjislativës nacionale relevante, përfshirë edhe dokumentet strategjike dhe politike që ndërlidhen me dhunën në familje; Shqyrtimin e gjendjes rreth zbatimit të planeve aksionale vjetore të Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011; Shqyrtimin e raporteve vjetore, procesverbaleve nga takimet punuese të OKN-së, vlerësimeve të institucioneve relevante nacionale, si dhe të analizave dhe raporteve të organizatave ndërkombëtare; Vlerësimin e statusit të zbatimit të Strategjisë 2008-2011, përfshirë edhe identifikimin e pengesave dhe sfidave, si dhe anët e fuqishme. Metoda dominante e cila është zbatuar është analiza e dokumenteve në kombinim me metodën kronologjike-tematike dhe diskutimet në grupet e fokusit. Përfitim i posaçëm nga zbatimi i kësaj metodologjie në punë është zhvillimi i diskutimeve me grupet e fokusit në nivel lokal. Grupet e fokusit kanë karakter shumësektorial, ndërsa pjesëmarrësit u përzgjedhën sipas rolit të tyre në parandalimin dhe sipas përgjegjësisë së tyre në mbrojtjen nga dhuna në familje. Përpos mungesës së hulumtimeve gjithëpërfshirëse shkencore për dhunën në familje në vend, evidente është edhe mungesa e grumbullimit sistematik të të dhënave statistikore për prevalencën, incidencën dhe llojet e dhunës në familje. Të dhënat e vetme statistikore zyrtare për rastet e dhunës në familje përpunohen nga Ministria e punëve të brendshme dhe nga Ministria për punë dhe politikë sociale. Të dhënat që grumbullojnë dhe analizojnë këto dy ministri të lartpërmendura japin vetëm numrin e rasteve të paraqitura dhe llojet e shërbimeve të siguruar dhe nuk reflektojnë pasqyrën e vërtetë për përmasat e dhunës në familje dhe për të gjitha llojet e dhunës në familje. Si pikënisje, kjo strategji merr të dhënat për dhunën në familje që janë siguruar nga tre hulumtime nacionale të zbatuara në dy vitet e fundit⁷⁰. Gjatë përpilimit të Strategjisë, mes aktorëve relevantë pati një konsensus të gjerë rreth qëllimeve strategjike dhe masave politike me prioritet që duhet të ndërmerren në periudhën që pason.

⁷⁰ „Të keqtrajtuar e të njollosur“ - Analizë e gjendjes me keqpërdorimin seksual të fëmijëve, UNICEF, 2010; Prevalenca e keqpërdorimit të personave të moshuar, SZO, 2012 ; Hulumtim nacional për dhunën në familje, UNDP, 2012.

Janë marr parasysh analizat dhe rekomandimet që janë përfshirë në Raportin e BE-së për progresin e vendit për vitin 2011 në lëminë e luftës kundër dhunës në familje. Ekspertiza teknike e siguruar nga Programi i përbashkët për dhunën në familje i organizatave të Kombeve të Bashkuara, “Përforcimi i kapaciteteve nacionale për parandalimin e dhunës në familje”, ka kontribuar në mënyrë thelbësore drejt zhvillimit të kësaj Strategjie. Si pika kyçe në përcaktimin e prioriteteve dhe të metodologjisë për përgatitjen e Strategjisë nacionale për parandalim dhe mbojtje nga dhuna në familje 2012-2015 janë përdorur rekomandimet e analizave vendore dhe ndërkombëtare. Njëkohësisht, gjatë përpilimit të strategjisë u morrën parasysh edhe rekomandimet e Ad Hok – Komitetit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje (CAHVIO), që u formua për përpilimin e tekstit të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje, të cilën Republika e Maqedonisë e firmosi në vitin 2011. Strategjia mbështetet në dokumente strategjike, në dokumente ndërkombëtare dhe në legjislaturën nacionale⁷¹

3.2 Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në frymën e harmonizimit të legjislacionit pozitiv të Republikës së Maqedonisë me legjislacionin e Unionit Evropian (si rezultat i synimit të integritetit të vendit tonë në UE) si dhe duke u bazuar në deklaratat dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe mbrojtjen e viktimave të saj, Kodi Penal i RM-së ka bërë një hap të rëndësishëm sa i përket rregullimit inkriminues të dhunës në familje me ndryshimet e vitit 2004. Dhuna në familje është e inkriminuar në kuadër të veprave penale ekzistuese në legjislacionin penal, me përcaktimin e dënimeve më të rënda dhe të ndjekjes penale sipas detyrës zyrtare kur vepra penale është kryer në kuadër të dhunës në familje, pra dhuna në familje dallohet si një lloj i veçantë i krimit.⁷²

Kështu në nenin 122 pika 21 dhuna familjare definohet si: “Me dhunë familjare nënkuptohet maltretimi, fyerja e vrazhdë, kërcënim i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore apo dhunë tjetër psikike apo fizike me të cilën shkaktohet ndjenjë e pasigurisë, kërcënim apo

⁷¹ Shih Aneksin II

⁷² Vedije Ratkoceri, Mbrojtja institucionale dhe ligjore e viktimave të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, Shkurt, 2012 fq. 46

frikë, ndaj bashkëshortit/bashkëshortes, prindërve apo fëmijëve apo personave të tjerë që jetojnë në bashkësi të përbashkët, si dhe ndaj bashkëshortit/bashkëshortes së mëparshëm/me apo personave të tjerë që kanë fëmijë të përbashkët apo gjenden në raporte të afërta personale.⁷³ Ky ndryshim ishte i domosdoshëm si në aspektin preventiv ashtu edhe në atë represiv, pra, ishte i domosdoshëm dhe i rëndësishëm ashpërsimi i represionit penalo-juridik me qëllim të luftimit sa më të suksesshëm të dhunës në familje në shtetin tonë. Para se të bëheshin këto ndryshime çështja e dhunës në familje trajtohej në kuadër të veprave të tjera të përgjithshme penale në Kodin Penal të RM-së.

Në Kodin Penal janë inkriminuar të gjitha format e manifestimit të dhunës në familje: dhuna fizike, dhuna psikike dhe dhuna seksuale. Dhuna fizike inkriminohet në veprat penale si marrja e jetës, dëmtimi ose shkelja e integritetit trupor, lëndimet trupore, lëndimet e rënda trupore etj. Format e dhunës psikike inkriminohen në veprat penale si detyrimi, heqja e lirisë në mënyrë të paligjshme, rrezikimi i sigurisë kurse forma e dhunës seksuale sanksionohet përmes veprës penale përdhunim, marrëdhënie seksuale me një person me nevoja të veçanta, sulm seksual ndaj një fëmije dhe ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit.⁷⁴

Veprat penale të parapara në Kodin penal⁷⁵ të sanksionuara posaçërisht për rastet kur kryhen si pasojë e dhunës në familje janë: vrasja (neni 123), vrasja në çast (neni 125), lëndime trupore (neni 130), lëndimi i rëndë trupor (neni 131), detyrimi (neni 139), privim i kundërligjshëm nga liria (neni 140), rrezikimi i sigurisë (neni 144), ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit (neni 191) dhe vepra penale sulm seksual ndaj të miturit që nuk ka mbushur 14 vjet (neni 188). Me ndryshimet në fjalë, Kodi penal përcakton se gjithmonë kur do të kryhet ndonjëra nga veprat e lartpërmendura penale gjatë dhunës familjare, konsiderohet si formë më e rëndë e veprës penale, ndërsa sanksioni është më i madh nga forma themelore e veprës së njëjtë penale, respektivisht:

- vepra penale lëndim trupor në paragrafin e parë thotë: ai i cili tjetërkujt do ti shkaktojë lëndim trupor ose do t'ia keqësojë shëndetin, do të dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre vjet, kurse në paragrafin e dytë thotë: ai që do të kryejë veprën nga paragrafi

⁷³ Kodi penal i RM-së :Tekst integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime,treguesi alfabetik, Doc. Dr. Afrim Osmani, Furkan, Shkup, 2010, f. 123

⁷⁴ Vedije Ratkoceri, Mbrojtja institucionale dhe ligjore e viktimave të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, Shkurt,2012 fq. 47

⁷⁵ Kodi Penal i RM-së, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.7/08.

- 1 gjatë kryerjes së dhunës familjare do të dënohet me burgim prej gjashtë deri në tre vjet.
- vepra penale lëndim i rëndë trupor në paragrafin 1 thotë: ai i cili tjetrin rëndë do ta lëndojë në trup apo rëndë do të ia keqësojë shëndetin, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet, kurse paragrafi dytë: ai i cili do ta kryejë veprën nga paragrafi 1 gjatë kryerjes së dhunës familjare do të dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.
 - vepra penale detyrimi – ai i cili me forcë ose me kërcënim serioz do të detyrojë tjetërkënd të kryej apo të mos kryej apo të durojë diçka, do të dënohet me dënim me gjobë ose me burgim deri në një vit, kurse në paragrafin e dytë thuhet: nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer gjatë kryerjes së dhunës familjare, kryerësi do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.
 - vepra penale privim i kundërligjshëm nga liria – ai i cili në mënyrë të kundërligjshme do të burgosë tjetër kë, do ta mbajë të burgosur apo në mënyrë tjetër do t'ia marrë apo kufizojë lirinë e lëvizjes, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet, kurse paragrafi i dytë thotë se: nëse vepra nga paragrafi 1 është kryer gjatë kryerjes së dhunës familjare, kryerësi do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.
 - vepra penale rrezikim i sigurisë – ai i cili do ta rrezikojë sigurinë e tjetrit me kërcënim serioz se do të atakojë jetën apo trupin e tij, ose trupin apo jetën e ndonjë të afërmi të tij, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj, kurse paragrafi i dytë thotë: ai i cili do ta kryejë veprën nga paragrafi 1 gjatë kryerjes së dhunës familjare, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

Kodi Penal përmban edhe një kapitull të veprave penale të titulluar Veprat penale kundër martesës, familjes dhe rinisë. Në këtë kapitull janë të përfshira këto vepra penale: bigamia (neni 195), mundësimi i lidhjes së martesës së palejueshme (neni 196), jeta martesore me person të mitur (neni 197), marrja e të miturit (neni 198), ndryshimi i gjendjes familjare (neni 199), braktisja e fëmijës së paaftë (neni 200), lënia pas dore dhe keqtrajtimi i personit të mitur (neni 201), mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 202), shkelja e obligimeve familjare (neni 203) dhe shërbimi i të miturve me pije alkoolike (neni 204).

3.3 Ligji mbi parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Ky ligj rregullon veprimin e përgjegjshëm dhe të duhur të institucioneve dhe shoqatat, koordinimi dhe bashkëpunimi i tyre i ndërsjellë, me qëllim të parandalimit dhe parandalimin e dhunës në familje dhe sigurimin e mbrojtjes së viktimave. (Neni 1).⁷⁶

Qëllimi i ligjit është ndërmarrja e masave të orientuara në parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, jetës, integritetit personal, mosdiskriminimit dhe barazisë gjinore, me kujdes të plotë mbi interesat dhe nevojat e viktimës.⁷⁷

Qëllimi i ligjit është të marrë masa që synojnë parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhuna në familje, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, jeta, personale integriteti, mos-diskriminimi dhe barazia gjinore, duke marrë parasysh interesat e duhur dhe nevojat e viktimës. (Neni 2)⁷⁸

Dhuna në familje do të thotë ngacmim, fyerje, rrezikim i sigurisë, dëmtimi trupor, seksual ose psikologjik, fizik ose ekonomik dhuna që shkakton një ndjenjë pasigurie, kërcënimi ose frike, përfshirë kërcënimet e veprimeve të tilla kundër një bashkëshorti, prindërve ose fëmijëve ose personat e tjerë që jetojnë në një bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose shtëpi të përbashkët, si dhe ndaj bashkëshortit aktual ose ish-partnerit, partnerit jashtëmartesor ose personave të cilët kanë një fëmijë së bashku ose janë në një lidhje të ngushtë personale, pavarësisht nëse kryesi i veprës ndau të njëjtën banesë me viktimën apo jo. (Neni 3)⁷⁹

Qendra për punë sociale i ndërmerr masat për mbrojtjen e viktimave, si vijojnë:

- 1) vendosje në qendër për persona – viktimë të dhunës në familje;
- 2) mbrojtje shëndetësore përkatëse;
- 3) intervenim përkatës psikik-social dhe trajtim;
- 4) trajtim psikik-social në këshillimore;

⁷⁶ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, neni 1

⁷⁷ Po aty neni 2

⁷⁸ Po aty

⁷⁹ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 138 nga 17.09.2014

- 5) ndihmë të familjes për shkollimin e rregullt të fëmijës;
- 6) ndihmë juridike dhe përfaqësim dhe
- 7) përforsim ekonomik të viktimës përmes përfshirjes së saj aktive në tregun e punës.⁸⁰

Vëmendje e veçantë i kushtohet përmirësimit të legjislacionit kombëtar në përputhje me dokumentet ndërkombëtare. Për të përmirësuar sistemin e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje si dhe zbatimin e suksesshëm të dispozitave të Ligjit për Parandalimin, Pengimin dhe Mbrojtjen nga dhuna në familje, pesë (5) akte nënligjore u miratuan nga autoritetet. Këto akte nënligjore përcaktojnë mënyrën e zbatimit dhe monitorimin e masave për mbrojtjen nga dhuna në familje, vlerësimin e rrezikut për jetën dhe integritetin fizik të viktimës dhe rrezikun e përsëritjes së dhunës, mënyrën e kryerjes së masave të përkohshme për mbrojtjen e viktimës të dhunës në familje dhe anëtarëve të familjes së saj dhe mënyrën e kryerjes së masës së përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje.⁸¹

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria për drejtësinë, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet që kryejnë veprimtari nga 3 në 18 fusha e mbrojtjes sociale, mbrojtja e fëmijëve, punët e shtëpisë, shëndetësia, punësimi dhe arsimit, të marrin masa për të mbrojtur viktimën dhe parandaluar dhuna, arrihet bashkëpunimi dhe koordinimi i ndërsjellë. Institucionet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të detyruar të sigurojnë punët nga të tyret kompetenca që do të kryhet nga ekspertë, të trajnuar për të zbatuar detyrat e caktuara me këtë ligj dhe dhunën e bazuar në gjini. Gjykata kompetente do të vendosë masa të përkohshme për mbrojtjen e viktimave, në përputhje me këtë ligj. Institucionet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe gjykata kompetente themelojnë një të veçantë regjistrime të dhunës në familje, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale. Forma dhe përmbajtja e formularit për shkëmbimin e të dhënave nga autoritetet institucionet për notat e nevojshme për të monitoruar situatën me dhunën në familje, si dhe mënyra e shkëmbimit të të dhënave nga institucionet përcaktohet nga Ministri i Punës dhe politika sociale.⁸²

⁸⁰ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, neni 18

⁸¹ Raporti vjetor për aktivitetet e ndërmarra dhe progresi i arritur për krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2018 - Ministria për punë dhe politikë sociale

⁸² Po aty

Një fëmijë është viktimë kur pëson dhunë të drejtpërdrejtë, kur është i pranishëm në marrëdhënie të dhunshme ndërmjet anëtarët e familjes së tij ose kur ai jeton në një mjedis në të cilin ka marrëdhënie të dhunshme. Masat e përkohshme nuk zbatohen për një fëmijë që kryen dhunë në familje mbrohen nga ky ligj dhe zbatohen dispozitat e Ligjit për Drejtësinë e Fëmijëve dhe dispozitat e Ligjit për Familjen në lidhje me rregullimin e marrëdhënieve të prindërit dhe fëmijët, mbikëqyrja mbi ushtrimin e të drejtave prindërore dhe kujdestarisë. (Neni 10)⁸³

Sa i përket ligjit për mundësi të barabarta të meshkujve dhe femrave, sipas nenit 1 paragrafi 1: rregullohen vendosja e mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve, masat themelore dhe të posaçme për vendosjen e mundësive të barabarta të femrave dhe meshkujve, të drejtat dhe obligimet e subjekteve për sigurimin e mundësive të barabarta të femrave dhe meshkujve, procedura për vertetimin e trajtimit të pabarabartë të femrave dhe meshkujve si dhe të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit juridik për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve (në tekstin e mëtejshëm: përfaqësuesi) si person i caktuar për realizimin e procedurës për përcaktimin e trajtimit të pabarabarte të femrave dhe meshkujve.⁸⁴

Qëllimi i këtij ligji është vendosja e mundësive të barabarta të femrave dhe meshkujve në sferën politike, ekonomike, sociale, të arsimit, kulturës, shëndetësisë, qytetare dhe në cilën do sferë të jetës shoqërore. Vendosja e mundësive të barabarta është kujdes i tërë shoqërisë, përkatësisht të gjitha subjekteve në sektorin publik dhe privat dhe paraqet largim të pengesave dhe krijim të kushteve për realizimin e barazisë së plotë mes femrave dhe meshkujve⁸⁵

Diskriminim në bazë të gjinisë është çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë të gjinisë, që ka si pasoje ose për qëllim ta rrezikojë ose pamundësojë njohjen, realizimin ose praktikimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në bazë të barazisë së femrave dhe meshkujve në sferën e politikës, ekonomisë, shoqërisë, kulturës dhe sferën qytetare ose tjetër, pa dallim të racës së tyre, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkatësisë së grupit të marginalizuar, perkatesisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit ose besimit fetar, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesave trupore ose mentale, moshës,

⁸³ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 138 nga 17.09.2014

⁸⁴ Ligji për mundësi të barabarta midis meshkujve dhe femrave, neni 1

⁸⁵ Ligji për mundësi të barabarta midis meshkujve dhe femrave, neni 2

gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore ose cilësdo bazë tjetër.⁸⁶

KAPITULLI IV

4. Studimi empirik

4.1 Veprat penale si pasojë e dhunës në familje në Gjykatën Themelore

Gostivar gjatë periudhës 2014-2019

Në pjesën e veprave penale që janë të lidhura me dhunën në familje gjatë periudhës hulumtuese janë zbuluar dhe paraqitur gjithsej 158 vepra penale, të njëjtat të kryera nga ana e 161 kryerësve kundër të cilëve janë ngritur 158 akuza penale deri te Prokuroria Themelore Publike në Gostivar. Veprat penale janë kryer në dëm të gjithsej 167 personave, viktima të dhunës në familje ku të njëjtit janë edhe paraqitësit e veprave penale që ndiqen sipas propozimit, gjegjësisht ndjekja pranohet sipas detyrimit zyrtar.

Periudha hulumtuese	n. 123	n. 123 p. 19	n. 130 p. 2	n.131 p. 2	n. 133 p. 2	n. 144 p.2	Vepra penale gjithsej te paraqitura	Kryerës gjithsej të paraqitur	Gjithsej paraqitje penale të dorëzuara
Viti 2014	/	/	8	/	/	/	8	8	8
Viti 2015	/	/	28	/	/	/	28	28	28
Viti 2016	/	/	26	/	7	13	46	47	46
Viti 2017	1	2	17	/	2	/	22	22	22
Viti 2018	/	/	21	/	/	5	26	26	26
Viti 2019	/	/	19	1	/	11	31	33	31
GJITHSEJ	1	2	119	1	9	29	161	164	161

⁸⁶ Ligji për mundësi të barabarta midis meshkujve dhe femrave, neni 4

Gjatë vitit 2014 deri te Prokuroria Themelore Publike – Gostivar janë dorëzuar gjithsej 8 paraqitje penale kundër 8 kryerësve të 8 veprave penale, “lëndim trupor gjatë kryerjes së dhunës familjare”, e paraparë dhe e dënueshme sipas nenit 130 paragrafi 2 i Kodit Penal së RMV.

Gjatë vitit 2015 deri te Prokuroria Themelore Publike – Gostivar janë dorëzuar gjithsej 28 kallëzime penale kundër 28 kryerësve të 28 veprave penale, “lëndim trupor gjatë kryerjes së dhunës në familje”, e paraparë dhe e dënueshme sipas nenit 130 paragrafi 2 i Kodit Penal së RMV.

Gjatë vitit 2016 deri te Prokuroria Themelore Publike – Gostivar janë dorëzuar gjithsej 26 kallëzime penale kundër 27 kryerësve të 26 veprave penale, “ lëndim trupor gjatë kryerjes së dhunës në familje”, e paraparë dhe e dënueshme sipas nenit 130 paragrafi 2 i Kodit Penal së RMV, të dorëzuar gjithsej 7 kallëzime penale kundër 7 kryerësve të 7 veprave penale “ kërcënim me armë të rrezikshme gjatë përleshjeve dhe zënkave gjatë kryerjes së dhunës në familje, e paraparë dhe e dënueshme sipas nenit 133 paragrafi 2 i Kodit Penal së RMV dhe të dorëzuara gjithsej 13 kallëzime penale kundër 13 kryerësve të 13 veprave penale, “cënimi i sigurisë gjatë kryerjes së dhunës në familje, e paraparë dhe e dënuar sipas nenit 144 paragrafi 2 i Kodit Penal së RMV.

Gjatë vitit 2017 deri te Prokuroria Themelore Publike – Gostivar janë dorëzuar gjithsej 22 kallëzime penale kundër 22 kryerësve kundër 1 veprave penale, “vrasje gjatë kryerjes së dhunës në familje” e paraparë dhe e dënuar sipas nenit 123 të Kodit Penal së RMV, 17 vepra penale lëndim trupor, neni 130 paragrafi 2 dhe gjithsej 2 kallëzime penale kundër 2 kryerësve, kundër 2 veprave penale “cënim me armë të rrezikshme gjatë përleshjeve dhe zënkave gjatë kryerjes së dhunës në familje neni 133 paragrafi 2.

Gjatë vitit 2018 deri te PTHP Gostivar janë dorëzuar 21 kallëzime penale kundrejt 21 kryerësve të 21 veprave penale, “ lëndim trupor” neni 130 paragrafi 2 dhe të dorëzuara 5 kallëzime penale kundrejt 5 kryerësve të 5 veprave penale, “cënim i sigurisë” neni 144 paragrafi 2 .

Gjatë vitit 2019 gjithsej janë dorëzuar 19 kallëzime penale kundrejt 21 kryerësve të 19 veprave penale “lëndim trupor” neni 130 paragrafi 2, si dhe 11 kallëzime penale kundrejt 11

kryerësve të 11 veprave penale “cënim i sigurisë gjatë dhunës në familje” neni 144 paragrafi 2, dhe 1 vepër penale “lëndim i rëndë trupor” neni 131 i Kodit Penal të RMV.⁸⁷

4.2 Lloji i veprës penale

Në tabelën më poshtë janë të paraqitura disa statistika të marra-burim nga Gjykata e Apelit në qytetin e Gostivarit, ku kryesisht tabela është e ndarë në tre rubrika, edhe atë: periudha kohore tregon se për cilat vite bëhet fjalë më konkretisht, numri i rasteve të paraqitura (kuptohet që ky numër nuk është i saktë për dallim nga ajo që ne vet e dimë se numri i rasteve të ndodhura realisht është më i lartë, si dhe llogji i veprës penale;

<u>Periudha kohore</u>	<u>Numri i rasteve</u>	<u>Lloji i veprës penale</u>
2015	27	Detyrim, përdhunime, lëndime të rënda trupore
2017	30	Vrasje, lëndime trupore
2018	44	Kanosje e sigurisë, lëndime trupore, lëndime të rënda trupore, vrasje
2019	1	vrasje ⁸⁸

4.3 Të dhënat gjinore

Në pjesën e veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje gjatë periudhës hulumtuese janë paraqitur gjithsej 164 kryerës, nga të cilët për 119 kryerës ekzistojnë dyshime të bazuara që janë kryerës të veprave penale “lëndim trupor” ose 73% nga gjithsej veprat e sublimuara gjatë periudhës hulumtuese, ndërsa më tutje vijnë veprat penale “cënim i sigurisë gjatë kryerjes së dhunës në familje”, me 18% ose gjithsej 29 vepra penale të regjistruara. Gjithashtu janë evidentuar 5% ose gjithsej 9 vepra penale “cënim me armë të rrezikshme gjatë zënkave dhe përleshjeve, dhe me 1% 1 vepër penale “lëndim i rëndë trupor”

⁸⁷ Për qëllimet e këtij hulumtimi kemi siguruar të dhënat nga policia e Gostivarit, për periudhën hulumtuese 2014-2019

⁸⁸ Gjykata e Apelit – Gostivar (Prokuroria Themelore Publike/Gostivar)

dhe “vrasje” si dhe 2% vepra penale “vrasje në tentativë”. Nga hulumtimi i bërë është konstatuar se 99% e kryerësve janë persona të moshës madhore dhe vetëm 1% janë minoren të ritur.

Si kryerës të veprave penale në numër më të madh janë paraqitur kryerës meshkuj edhe atë 159 persona ose e shprehur në % -97% të gjithsej kryerësve, ndërsa vetëm 5 kryerës janë femra ose 3%. Kjo do të thotë se pjesën më të madhe të dhunës në familje e kryejnë persona të gjinisë mashkullore edhe atë të moshës madhore. Sipas përkatësisë gjinore 134 janë bashkëshort ose persona meshkuj të cilët jetojnë me person femër në gjendje jashtëmartesore, 5 baballarë, 10 djem, 4 vëllezër dhe 6 persona në lidhje të tjera familjare të cilët jetojnë në bashkësi familjare të viktimave siç janë: vjehri, kunati, kushëriri etj. Nga kjo mund të konstatojnë se sipas strukturës familjare të kryerësve 84% janë bashkëshort ose persona meshkuj që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore. Gjithashtu janë regjistruar edhe 5 kryerëse femra nga të cilat 2 bashkëshorte ndërsa të tjerat në përkatësi tjetër familjare ku e kanë kryer dhunën në familje.⁸⁹

4.3.1 Gjinia dhe moshja e viktimave, raporti familjar me kryerësin

Si viktimat të dhunës në familje të njejtit paraqitës të viktimave janë paraqitur 167 persona nga të cilët 147 persona femra ose 88% të viktimave, kurse 12% e viktimave ose 20 persona të dëmtuar janë të gjinisë mashkullore. Në numrin më të madh ose 131 viktimat janë bashkëshort ose persona femra që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore me person mashkull ose e shprehur në 78% e numrit të përgjithshëm të personave të dëmtuar, ndërsa më tutje rradhiten me 7% ose 12 viktimat që janë prindër, 4% ose 7 janë fëmijë të regjistruar si viktimat të dhunës në familje të kryera nga ana e prindërve të tyre ose baballarëve, ndërsa pjesa tjetër prej 11% ose gjithsej 17 viktimat i takojnë anëtarëve të tjerë të bashkësisë familjare siç janë: vëllezërit, motra, gjyshja, gjyshi, nipi, vjehrrit dhe nuset.⁹⁰

⁸⁹ Gjykata e Apelit – Gostivar (Prokuroria Themelore Publike/Gostivar)

⁹⁰ Po aty


4.4 Anketë

Kjo anketë është përgatitur dhe publikuar në rrjetin social Instagram, ku ishin parashtruar gjithsej 7 pyetje, ku në përfundim të anketës figuronin gjithsej 745 përgjigje, përgjigje ato nga grup moshë të ndryshme, edhe atë:

1. Cila veprë penale e dhunës në familje praktikohet më së shumti?
2. A njihni ndonjë rast të dhunës në familje afër jush dhe si keni vepruar?
3. Përse mendoni se femrat janë më shumë viktime të dhunës në familje?
4. Sa mendoni se raportohet dhuna në familje?
5. Përse mendoni se burrat janë më pak të prekur si viktime të dhunës në familje?
6. Fëmijë të shëndoshë apo me sëmundje të ndryshme si viktime të dhunës në familje?
7. A luan rol moshë e fëmijëve të prekur si viktime të dhunës në familje dhe në bazë të saj a dallon vepra penale që i prek ato?

Cila veprë penale e dhunës në familje praktikohet më së shumti?

737 responses



Sa i përket pyetjes: “Cila veprë penale e dhunës në familje praktikohet më së shumti”, ku janë përgjigjur 737 anketues ku nga ata janë të mendimit se:


- **43.7% të ndryshme,**
- **32.8% dhuna fizike;**
- **22.9% dhuna emocionale; dhe**

- *pjesa e ngelur i përket dhunës seksuale;*

A njihni ndonjë rast të dhunës në familje afër jush dhe si keni vepruar ju?



735 responses




Kur vim tek pyetja “ a njihni ndonjë rast të dhunës në familje afër jush dhe si keni vepruar ju” menjëherë jemi të mendimit se shumica ndoshta edhe ngurojnë të përgjigjen saktë, megjithatë:

- **55.4% nga të anketuarit: Nuk njoh;**
- **36.9% Nuk e kam raportuar; dhe**
- **7.8% E kam raportuar;**

Përse mendoni se femrat janë më shumë viktima të dhunës në familje?

741 responses




Kjo pyetje edhe vlen të diskutohet gjërë e gjatë sa i përket femrës dhe arsyt se pse ata janë më shumë të prekur si viktimë të dhunës në familje, 741 nga të anketuarit janë të mendimit se:

- **65% Arsimimi\Mentaliteti;**

- **24.2% Paragjykimet;**
- **10.8% Dobësia e femrës;**

Sa mendoni se raportohet dhuna në familje?

740 responses



“Sa mendoni se raportohet dhuna në familje?” 740 anketues të sondazhit janë përgjigjur:


- **67.7% Ndonjëherë;**
- **28.9% Aspak; dhe**
- **Pjesa e ngelur është Gjithmonë;**

Fatkeqësisht në vendin tonë është shumë e vërtetë, ku për këtë shkak kemi të bëjmë me numrin e errët të rasteve të dhunës në familje që ngelin vetëm brenda familjes.

Përse mendoni se burrat janë më pak të prekur si viktimë të dhunës në familje?



736 responses



Një nga pyetjet që kam pritur me padurim rezultatin është kjo: Përse mendoni se burrat janë më pak të prekur si viktimë të dhunës në familje, 736 anketues mendojnë që:

- **62.1% Patriarkalizmi;**
- **26.9% Toleranca e femrës;**
- **11% Fiziku;**

Rezultati çuditërisht nuk ishte ashtu siç mendoja se mund të dal, me më shumë % prisja të jetë fiziku, por që mbizotëron patriarkalizmi dhe nga njëra anë jam e lumtur duke e ditur faktin që nga të anketuarit janë edhe meshkuj por domethonë që jo çdoherë ata mendojnë se forca e tyre fizike mund të sundoj gjininë e kundërt.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përfundim të gjithë kësaj, nga ajo çka u tha më lartë, është shumë me rëndësi në pikë të parë të ndihmohen personat viktimë sa i përket kësaj fushe, ku në këtë mënyrë ne minimalizojmë të ashtuquajturën një shoqëri devijante. Sa i përket ndihmës së viktimave gjithashtu duhen hapur qendra strehuese, rehabilituese ku në këtë mënyrë ato ndihmohen nga aspekti moral, financiar, traumatik, etj.

Në qytetin tonë gjithmonë kanë qenë e mangët nismat e një qendre, dhe kjo është një nga arsyet kryesore përse qyteti jonë pason nga këto dhunues.

Shoqëria më tej, duhet të jetë shumë e informuar rreth ligjeve dhe në çfarë mënyre preket një person për të qenë pre e dhunës. Në këtë mënyrë ata vetëdijësohen duke i ndihmuar dhe përkrahur shoqërinë e tyre nëse dallojnë se ata mund të jenë të prekur nga dhuna në familje. Ndodh shpesh që ata si viktimat të ngurojnë të tregojnë se dhunohen nga familja e tyre për arsye turpi, frike apo nga ideja se do të përjashtohen nga shoqëria e tyre.

Sa jemi tek shoqëria, këtu bën pjesë edhe shkollat si institucion arsimor, ajo e cila duhet të ngrit tema të veçanta rreth kësaj çështje, duke ngritur vetëdijësimin e të rinjve, si duhet reaguuar në raste dhune, se dhuna nuk është vetëm pjesë e familjes, ajo duhet paraqitur dhe denoncuar, kur në këtë mënyrë arrihet një shoqëri jo e dhunshme dhe duke respektuar njëri tjetrin.

E drejta e të jetuarit i lirë, pa frikë është e drejta primare e çdo individi, ne dhe çdokush ka të drejtën të jetoj në mënyrën e vet dhe të di çfarë të drejtash dhe ndihmash u takojnë. Për këtë arsye duhet pasur persona të caktuar duke i informuar qytetarët duke nisur nga format më të thjeshta informative ku në këtë prapavijë qëndron shteti, ku duhet dhënë kontributin maksimal për të treguar efikasitet, duke përfshirë këtu disa kategori, si: ligje, kampanja, organizime të ndryshme, projekte, si dhe media dhe bota e shkrimit duhet të jenë më në rrjedha duke publikuar shkrime duke i bashkangjitur ato me ideja, ligje, numra telefoni ku duhet thirrur etj.

Të mos harrojmë fëmijët duke i përkrahur në mënyrën më të mirë të mundshme, duke hapur qendra speciale, duke e ndarë atë në bazë të grup moshave dhe shëndetit të tyre, për arsye se ata janë e ardhmja e një populli, rritja e tyre në mënyrë të shëndetshme nënkupton një rreth shoqëror të shëndoshë!

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Libra:

- Doc. Dr. Afrim Osmani, Furkan Kodi penal Shkup
- Davis, R. (1998) , Domestic Violence: Facts and Fallacies, Westport: Praeger Publishers, ST.Çaçeva, V., Frishçiq, J., Mishev, C., (2007), Jetë në hije, ESE.Shkup
- Hamdi Podvorica, E drejta familjare, Prishtinë 2005
- Autor:Adem Tamo, Theodhori Karaj, Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri, Qendra e zhvillimeve humane , Raport studimor i financuar nga UNICEF , Tiranë, 2006
- Hollin, C: Social learning theory, “ The sage Dictionary of Criminology”, Sage, 2001
- Gelles R. Family :”Family violence”, Oxford,1998
- Arata, C. M., Langhinrichsen-Rohling, J., Bowers, D., &O’Farrill-Swails, L. (2005). Single versus multi-type maltreatment:An examination of the long-term effects of child abuse. Journal ofAgression, Maltreatment & Trauma
- Kevin N. Wright dhe Karen E.” Family Life and Delinquency and Crime, viti 1993
- Prof.Rasim Gashi, Mësuesja e parë në Gostivar,2011
- Bradely, T, Përgjashtimi social te Fjalori i kriminologjisë, Sage, Londër, 2001
- Dr.Ragip Halili -Kriminologjia,-Prishtinë 2002
- Minnesota Advocates for Human Rights, Domestic Violence in Macedonia, 1998
- Bistra Netkova, Të drejtat e njeriut dhe dhuna në familje, Universiteti i Evropës Jug-Lindore, 2007
- Kurtesh Saliu “E drejta kushtetuese”- Prishtinë, 1998
- Doc. Dr. Afrim Osmani, Furkan, Kodi penal i RMV-së: Tekst integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime,treguesi alfabetik, Shkup, 2010

Artikuj shkencor:

- Vedije Ratkoceri - Mbrojtja institucionale dhe ligjore e viktimave të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë, temë masteri, Universiteti i Tetovës, Tetovë 2012

- Bistra Netkova, Ciceron për anëtarët e odës së avokatëve e cila u siguron ndihmë juridike viktimave të dhunës në familje, Shkup, 2010
- Qendra e Aleancës gjinore për zhvillim, Raporti: Dhuna në familje: paraqitje e situatës aktuale, Tiranë, 2006
- Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, Hulumtimi: Jeta në hije, Shkup, 2007
- Dhuna në familje, Përgjegjësitë që ka policia e shtetit për parandalimin dhe reduktimin e saj, UNDP/Japan WID Fund Support, Tiranë, 2008
- Hulumtimi: Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, Jeta në hije, Shkup, 2007
- Holly L. Wegman, Cinnamon Stetler, A Meta-Analytic Review of the Effects of Childhood Abuse on Medical Outcomes in Adulthood, Shoqata Amerikane e Psikosomatikës
- Levay, M., Përrjashtimi social: Një koncept në lulëzim në kriminologjinë bashkëkohore; Përrjashtimi social dhe krimi në Europën Qendrore dhe Lindore të “Politikat penale, reformat në drejtësi dhe përrjashtimi social”, publikimi nr. 48 i Institutit European të Parandalimit dhe Kontrollit të Kriminologjisë, HEUNI, Helsinki, 2007
- „Të keqtrajtuar e të njollosur“- Analizë e gjendjes me keqpërdorimin seksual të fëmijëve, UNICEF, 2010; Prevalenca e keqpërdorimit të personave të moshuar, SZO, 2012 ; Hulumtim nacional për dhunën në familje, UNDP, 2012
- Raporti vjetor për aktivitetet e ndërmarra dhe progresi i arritur për krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2018 - Ministria për punë dhe politikë sociale
- Preventing intimate partner and sexual violence against women: taking action and generating evidence, Geneva, World Health Organization, 2010

Ligje dhe Konventa ndërkombëtare

- Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje
- Deklarata e OKB-së për eliminimin e dhunës kundër grave, miratuar me Rezolutën e Asamblesë së përgjithshme A/RES/48/104, 20.12.1993
- Konventa e këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

- Konventa për të drejtat e fëmijës, Rezoluta e Asamblesë së përgjithshme e OKB-së 44/25, 20.11.1989 • Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta zyrtare e RM-së 52/92
- Kodi Penal i RMV-së, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.7/08
- Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 138 nga 17.09.2014
- Ligji për mundësi të barabarta midis meshkujve dhe femrave
- Legjislacionin nacional- Ligjin mbi familjen

Institucione

- Policia e Gostivarit
- Gjykata e Apelit – Gostivar (Prokuroia Themelore Publike/Gostivar)
- OBSH, Ministria e Shëndetësisë së RMV, Enti Republikan për mbrojtje shëndetësore, fondacioni institucional i hapur i shoqërsisë civile në Maqedoni, UNICEF

Linqe nga interneti

- <https://www.amnesty.org/download/Documents/76000/eur110022006sq.pdf>
- <https://sq.wikipedia.org/wiki/Dhuna> Krug et al., "World report on violence and health", World Health Organization, 2002
- <https://sq.wikipedia.org/wiki/Familja>
- https://sq.wikipedia.org/wiki/Deklarata_Universale_p%C3%ABr_t%C3%AB_Drejtat_e_Njeriut
- <https://esem.org.mk/en/pdf/Publikacii/Ostanati/2008/>
- <https://www.slideshare.net/erginushi/stop-dhuna>
- www.stopvaw.org/Effects_of_Domestic_Violence_on_Children.html
- http://www.unicef.org/protection/index_violence.html
- Argjira Ukimeri, Punim, Prizren 2011, <http://www.albaniapress.com/lajme/13822/NGRITJA-ARSIMORE-E-FEMRES.html>
- https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2019/09/Ezmeralda_Xheraj.pdf
- www.childhub.org/who.int – World Health Organization

